

1 E martë, 30 prill 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

8 Ju lutem, z. Sekretar u Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
13 Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
15 procesverbal, vërej që të gjithë të akuzuarit, me përjashtim
16 të z. Krasniqi, janë të pranishëm në gjykatë. Z. Krasniqi na
17 ndjek përmes videolidhjes pas marrjes së lejes përkatëse.

18 Përpara sesa të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
19 Prokurorisë 03865, vërej që deri tani versionet e Dëshmitarit
20 03865, të cilat janë pranuar si provë materiale si P01136.1
21 deri në P01136.4 nuk përmbajnë korrigjimet e diskutuara midis
22 palëve.

23 Trupi Gjykses e kupton që Mbrojtja e Thaçit i ka
24 rishikuar të gjitha korrigjimet e propozuara nga ZPS-ja dhe
25 dhe pajtohet me të gjitha ato, përveç korrigjimeve të

1 propozuara në provën materiale P01136.3-ET, faqja 20, rreshtat
2 21 deri në 23.

3 ZPS-ja këtë mëngjes ofroi një tjetër version të rishikuar
4 në përputhej me mosmarrëveshjet ose mospajtimet e Mbrojtjes së
5 z. Thaçi dhe do të doja t'i kërkoja z. Misetiç në qoftë se
6 pajtohet me versionin e rishikuar të ZPS-së.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne nuk pajtohemi. Do propozoja, i
8 nderuar Gjykatës, që të shkojmë në shqip me dëshmitarin dhe
9 dëshmitari pastaj të sqarojë se çfarë ka dashur të thotë me
10 pjesë të caktuara të materialeve përkatëse.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 Edhe diçka tjetër. Unë besoj që na është bërë një kërkesë
13 nga Mbrojtja e z. Veseli, megjithëse nuk është se jemi shumë
14 të qartë lidhur me këtë, domethënë, kemi të bëjmë me një
15 kërkesë që ne mendojmë që Mbrojtja e Veselit ka dorëzuar për
16 redaktimin e pjesën së shënimit përgatitor të Dëshmitarit
17 03865 për sa i takon mbështetëshmërisë nga ZPS-ja mbi
18 vërtetësinë e përmbajtjes së deklaratës së dëshmitarit.

19 Kundërshtimet e një natyre të ngjashme që përqendrohen në
20 detyrimin e palëve për të mos vendosur përpara Trupit Gjykses
21 informacion të ditur ose të besuar si i rremë janë bërë
22 gjithashtu edhe nga Mbrojtja e z. Thaçi.

23 Shënimi përgatitor është pranuar si prova materiale
24 P01137.

25 Trupi Gjykses do bëjë një propozim që ne besojmë që mund

1 të trajtojë çështjen në fjalë dhe që mund të jetë e drejtë për
2 të gjitha palët. Duke marrë parasysh atë çfarë tha z. Pace që
3 ZPS-ja nuk po përpiqet që të mbështetet te shënimi përgatitor
4 i Dëshmitarit 3865, në paragrafin 5, duke filluar nga fjala që
5 fillon me "provën 003817" dhe fjalët për "Uniformat e UÇK-së
6 dhe shenjat dalluese të UÇK-së" për vërtetësinë e përmbajtjes,
7 Trupi Gjykses nuk do të mbështetet mbi këtë fjali dhe do të
8 vlerësojë besueshmërinë e 3865 dhe jo vërtetësinë e
9 përmbajtjes së tij.

10 I njëjti vendim zbatohet gjithashtu edhe për fjalinë e
11 fundit të paragrafit që fillon me fjalët "gjatë leximit
12 përsëri mbrapsht" për dëshmitarin dhe që përfundon me fjalën
13 "në Budakovë". Në këto rrethana, për rrjedhojë, është e
14 panevojshme që të redaktohen seksionet e paragrafit 5 dhe
15 seksioneve të tjera të provës materiale P01137.

16 Dua t'ju kërkoj që të bëni parashtrime mbi këtë çështje.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, thjesht
18 dua që të më jepni një minutë për të parë fjalitë, për çfarë
19 fjalie bëhet fjalë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mund t'ju
21 them ekzaktësisht se cilat janë fjalitë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Reagimi im fillestar, i nderuar
23 Kryegjykatës, është që kjo do të tjetërsonte situatën. Dëshmia
24 e dëshmitarit është ajo që dëshmitari thotë në përgjigje të
25 pyetjeve.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju mund
2 ta pyesni dëshmitar lidhur me gjërat që doni në kundërpjetje.
3 Domethënë, me fjalë të tjera, çfarë po themi ne është që sa i
4 takon Trupit Gjykes ato fjali që unë citova më përpara nuk do
5 të përdoren për vërtetësinë për mbështetmërinë ose
6 besueshmërinë. Se çfarë bëni ju me këtë është puna juaj.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Prandaj po them që tjetërsohet
8 situata sepse fjalitë në dëshminë fillestare të ZPS-së nuk
9 mund të përdoren për të vërtetën sepse është betuar sipas
10 rregullit 154 dhe që shënimi përgatitor, paragrafi 5, është
11 dëshmia e tij.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është
13 parashtrimi juaj.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, kjo është e vërteta se ai këtë
15 e ka thënë nën betim. Dhe ai ka thënë të vërtetën duke marrë
16 parasysh edhe korrigjimet ose ndryshimet e paragrafit 5.

17 Pra, nëse do të marrim parasysh korrigjimet në paragrafin
18 5, atëherë i takon që betimi nuk është i vlefshëm plotësisht.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
20 kuptoj. E kuptoj situatën. E kuptoj argumentin tuaj,
21 parashtrimin tuaj.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pa u larguar nga parashtrimet e
23 z. Misetit, ne sugjerojmë që paragrafi 2 të mos merret
24 parasysh dhe dua që të përfshijë fjalinë e mëparshme që
25 përmban atë çfarë Prokuroria nuk e pranojnë si prova këtë, dua

1 të përfshihet gjithashtu edhe opinionin e z. Pace sa i takon
2 dëshmisë së dëshmitarit. Dhe citoj këtu atë çfarë ka dhënë z.
3 paçe dje:

4 "Pace vërejti që Dëshmitari 03865 ka dhënë informacion të
5 më hershëm jokonsistent me deklaratat e mëparshme në veçanti
6 në lidhje me Sadik Halitjahën".

7 Tani, në qoftë se do bëjmë redaktime sigurisht që fjalia
8 nuk duhet të ishte në këtë formë që është sepse nuk mendoj që
9 korrespondenca e bën më të qartë pozicionin e Prokurorisë dhe
10 çfarë sugjeron Prokuroria për sa i takon dëshmisë për qëllimin
11 e parashtrimit përpara Trupit Gjykses.

12 Ndërkohë pjesa që mbetet duhet që të përdoret vetëm
13 besueshmërinë dhe jo për vërtetësinë ose për të dëshmuar se
14 përmbajtja është e vërtetë, pra, z. Misetic thotë që kjo e
15 tjetërson situatën sepse shpesh herë gjatë ditës së djeshme
16 dëshmitarit ju bë pyetja në qoftë se kjo është dëshmia e tij
17 dhe ai tha që po është dëshmia e tij disa herë nën betim. Dhe
18 është e rëndësishme që të jepet një shpjegim për dëshmitarin,
19 jo sa i takon vërtetësisë së përmbajtjes së dëshmisë së tij
20 sepse dëshmitari këtë e ka thënë disa herë në mënyrë të
21 përsëritur pas pyetjeve përkatëse.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hezitojmë pak
23 sa i takon redaktimit të këtyre deklaratave se dikush e ka
24 thënë këtë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Z. Pace e ka thënë këtë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kanë thënë
2 të dyja palët në fakt, z. Pace dhe dëshmitari vetë.

3 Z. Robert, a dëshironi të thoni diçka?

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, jo. Me kënaqësi nuk dua të
5 futem në këtë diskutim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dua të vë
7 faj.

8 I gjithë koncepti i rregullës 154 është pak i çuditshëm
9 dhe për mua, nuk është kaq i njohur dhe për mua, domethënë,
10 është një rregull i cili shpeshherë gjeneron probleme.

11 Znj. Alagendra, ndonjë gjë për të shtuar?

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, nuk kam gjë për të shtuar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I kuptoj
14 parashtrimet tuaja. Do të mundohemi që t'i bëjmë të kuptimta
15 ato.

16 Z. Pace, doni të thoni diçka?

17 Z. PACE: [Përkthim] Më lejoni që të them në fillim fare
18 që duket sikur po bëjmë një dallim ndërmjet rregullës 154 dhe
19 marrjes së drejtpërdrejt në pyetje të dëshmitarit prej nesh
20 dhe, në fakt, nuk është e nevojshme që të bëjmë këtë dallim.
21 Rregulli 154 në mekanizmin e vet nuk është i ndryshëm nga
22 nxjerrja e informacionit *viva voce*. Ajo çfarë po bëjmë në këtë
23 dëshmitar nuk është e ndryshme nga ajo çfarë kemi bërë më
24 përpara dhe propozimi i Trupit Gjykses kërkon që ta bëjë të
25 qartë këtë dallim sa i takon propozimit të vendosur.

1 Ne nuk pajtohemi me parashtrimin e z. Veseli që thotë se
2 këto paragrafë nuk duhet të ishin vendosur fare në shënimin
3 përgatitor.

4 Unë do thoja e kundërta është e vërtetë që ishte shumë e
5 nevojshme për ne për të përfshirë këtë informacion në këto
6 paragrafë, sepse në të kundërtën në qoftë se nuk do i kishim
7 përfshirë dhe në qoftë se dëshmitarët do ta kishin nxjerrë atë
8 në informacion, atëherë do kishim qenë në një situatë të
9 vështirë. Askush nuk po thotë këtu që opinioni im është provë,
10 por sigurisht që nuk ka nevojë që të fillojmë të redaktojmë
11 informacion të kësaj natyre atje. E njëjta gjë zbatohet dhe
12 për transkript në sallën e gjyqit kur dikush diskretiton
13 dëshmitarin ose në deklaratat e shumta të rregullës 154.

14 Sa i takon propozimit tuaj, të nderuar anëtarë të Trupit
15 Gjykses, që ju thoni që mund të mbështetni vetëm tek pjesët
16 ose paragrafët që ju përmendët për qëllime të kufizuara.
17 Megjithatë në qoftë se do të ndjekim këtë logjikë disa prej
18 gjërave që dëshmitari ka thënë atje, nuk lidhen në mënyrë
19 tërësore dhe të domosdoshme me çështjen që kërkohet që të
20 diskretitojë atë.

21 Për shembull, një prej tyre ka të bëjë me një urdhër të
22 pashkruar nga shtabi i batalionit për të kërkuar persona. Për
23 shembull, mendoj që kjo do të jetë, kjo është një fjali me
24 vlerë për të gjitha palët.

25 Dhe nga ana tjetër fjalia e fundit e këtij paragrafi, siç

1 e thoni, ka të bëjë edhe me informacione të tjera sepse
2 dëshmitari thotë që kur flet për Sadik Halitjahën i referohet
3 batalionit. Ne duam që të tërheqim vëmendjen që fakti është që
4 versioni i vërtetë i dëshmitarit është ai që ka dhënë në vitin
5 2002 dhe jo në deklaratën e ZPS-së.

6 Kështu që në përmbledhje ne nuk pajtohemi me redaktimet
7 dhe ne nuk pajtohemi me nevojën për t'u mbështetur mbi këtë
8 propozim të kufizuar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Mettraux.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një pyetje për ju. Shumë
11 singerisht kur mora shënimin përgatitor kisha pak a shumë të
12 njëjtin reagim si z. Misetić, në kuptimin që kishte një
13 tregues të qartë se dëshmia e dhënë nga dëshmitari nuk ishte
14 në pajtim ose në të njëjtën linjë me dëshminë që ai kishte
15 dhënë me dëshmitë e mëparshme. Dhe besoj që Trupi Gjykses
16 duhet të të kishte bërë pyetje ty lidhur me këtë më përpara
17 dhe duhet të marrim një pjesë të përgjegjësisë lidhur me këtë.

18 Megjithatë duke parë nga e ardhmja, dua t'ju pyes se cili
19 është sugjerimi juaj, në qoftë se në seancën përgatitore ju
20 merrni versionin nga një dëshmitar që nuk janë në të njëjtën
21 linjë ose nuk janë në përputhje me versionet e mëhershme të
22 deklaratave të bëra prej tyre dhe ju i ofroni këto deklarata
23 dhe pastaj thoni që versioni i mëparshëm është i vërtetë dhe
24 ajo duhet të merret parasysh, pra, në një situatë të tillë
25 çfarë synoni të bëni? Sepse nuk mund të ofroni një version dhe

1 pastaj një version tjetër që është në kundërshtim me versionin
2 e parë dhe pastaj të jemi në një situatë të tillë.

3 Kështu që çfarë sugjerimi keni ju si duhet trajtuar kjo
4 gjë, domethënë, si? Nuk dua t'ju vë në situatë të vështirë,
5 por thjesht do të doja që të merrja mendimin tuaj, ndoshta në
6 qoftë se është e nevojshme edhe mendojeni përgjigjen dhe
7 ndoshta na jepni përgjigjen nga fundi i ditës sot.

8 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës

9 Të jem i singertë me ju, nuk propozoj që të vijojmë
10 ndryshe nga ç'kemi bërë deri tani. Fjalja në veçanti që tregoj
11 që është jokonsistente --

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk është se e kam vetëm
13 me atë.

14 Z. PACE: [Përkthim] Jo, çështja është se ajo çfarë ka
15 ndodhur në Gjykatë nuk besoj se është befasuese për askënd.
16 Sikurse e thashë dje dhe do ta përsëris përsëri sot, për ne
17 ajo çfarë është më e rëndësishmja është që ne të japim të
18 gjithë informacionin që kemi në dispozicion Trupit Gjykses dhe
19 pastaj Trupi Gjykses mund të gjykojë besueshmërinë e
20 dëshmitarit kur juve të merrni vendimin përkatës.

21 Për këtë arsye ne mendojmë, se në qoftë se kemi
22 deklaratën sipas rregullit 154 dhe në qoftë se kemi një dëshmi
23 të detajuar *viva voce* lidhur me atë se çfarë ka ndodhur nga
24 dëshmitari, besojmë që kjo është mënyra sesi ne mund t'ju
25 japim të gjithë panoramën e situatës. Ju garantoj që në qoftë

1 se do më kishit thënë që ta kisha pyetur *viva voce* këtë
2 dëshmitar dhe siç unë dua të bëj sipas Vendimit për Zhvillimin
3 e Procesit Gjyqësor o do ta konfrontoja ose do t'i rifreskoja
4 memorien se i takon mungesës së konsistencës ose ndryshimit të
5 dëshmisë së tij.

6 Megjithatë në këtë rast mungesa e konsistencës për herë
7 të parë ka dalë në pah gjatë seancës përgatitore me
8 dëshmitarin. Për shembull, bëhet fjalë dhe për një dëshmitar
9 që nuk do përmend as kodin se jemi në seancë të hapur dhe në
10 qoftë se ju kujtohet, pra, ju të nderuar Gjykatës na dhatë
11 leje që të pranojmë dëshminë e këtij dëshmitari sipas
12 rregullës 154, por, gjithashtu, na bëtë të mundur që të bënim
13 marrjen në pyetje *viva voce* të dëshmitarit. Megjithatë në atë
14 rast nuk kemi të bëjmë me të njëjtën situatë si në rastin në
15 fjalë, me dëshmitarin në fjalë.

16 Në qoftë se herë pas here, të nderuar Gjykatës, në qoftë
17 se do të merrni një qasje tjetër në situata të ngjashme dhe në
18 qoftë se ju mendoni që mënyra më e shpejtë për të vijuar më
19 tej do të jetë, për shembull, për të redaktuar pjesë të
20 deklaratës së mëparshme sipas rregullës 154 ku dëshmitari ka
21 thënë gjëra që janë të ndryshme nga marrja në pyetje *viva voce*
22 sigurisht që mund ta bëjmë këtë gjë në të ardhmen. Qoftë edhe
23 në përgatitje dhe më pas.

24 Por pyetja që ngre unë është cila është vlera e shtuar?
25 Dëshmitari, me përjashtim të rastit kur mund të ndryshojë

1 diçka brenda natës, dëshmitari njësoj do japë dëshmi
2 jokonsistente. Kështu që në këtë kuadër, sigurisht që unë do
3 kërkoj që të merret parasysh për vërtetësinë e dëshmisë
4 dëshmia e mëparshme e dëshmitarit. Për aq kohë sa kemi një
5 lloj njoftimi për preferencën tuaj dhe për marrjen në pyetje
6 *viva voce* të dëshmitarit, sigurisht që do ta bëjmë këtë gjë.
7 Nuk është e nevojshme sipas nesh, megjithatë në qoftë se do të
8 na urdhëroni, sigurisht që do ta bëjmë një gjë të tillë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të bërë
10 pyetjen që bëri z. Misetic, si e bëni dallimin ju midis asaj
11 që Prokuroria ka thënë dëshmitari tani dhe çfarë ka thënë ai
12 atëherë? Cili është qëndrimi juaj? Po thoni ju që të dyja
13 dëshmitë janë të vërteta?

14 Z. PACE: [Nuk ka përkthim]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sepse ju
16 duhet të vërtetoni që deklaratat janë të vërteta. Tani në këtë
17 pikë i takon që të dy deklaratat janë të vërteta sipas jush,
18 pra, lidhur me këtë dëshmitar.

19 Z. PACE: [Përkthim] Për të qenë të qartë, kur dëshmitari
20 thotë që kam dhënë deklaratë të saktë, kjo pasqyrohet në
21 shënimin përgatitor.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po i takon që
23 njëra nga deklaratat ë e rreme atëherë. I takon që njëra prej
24 dy versioneve nuk është e saktë. Atëherë cili është versioni i
25 saktë, për kë jepte dëshmi? Vetëm për të vërtetën besoj, apo

1 jo?

2 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Është e
3 vërtetë. Ai ka thënë që çfarë është e pasqyruar në shënimin
4 përgatitor ka epërsi ose është më e vërtetë sesa ajo çka ka
5 thënë në deklaratën e mëparshme. Megjithatë nuk ka fare çudi
6 ose habi në qëndrimin tonë. Sepse me pyetjet që unë bëra dje
7 për të konfrontuar dëshmitarin, besoj që e bëri të qartë për
8 të gjithë se çfarë qëndrimi kishte ai. Kështu që besoj se
9 ishte e qartë situata.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju nuk
11 po thoni që dëshmitari ka dhënë informacion të rremë, apo jo?

12 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk kemi kontroll se Prokuroria
13 thotë dëshmitari.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kjo ka të
15 bëjë me 154 është diskutim tjetër.

16 Z. PACE: [Përkthim] Më korrigjoni në qoftë se kam gabim,
17 megjithatë kur kolegu im më korrigjon mua, në qoftë se unë jam
18 gabim, ne propozojmë që deklarata sipas 154 është ajo që duhet
19 që të merret parasysh, pra, Prokuroria duhet që të mbështete
20 vetëm tek procedura, domethënë, ajo çfarë mund të bëjmë neve
21 është që dëshmitari të ndjekë procedurën dhe të thojë që po
22 them të vërtetën.

23 Ndërkohë që dje ne theksuam elementë të caktuar që sipas
24 nesh janë materialisht të ndryshme, kështu që për këtë arsye
25 këtë besoj që jua bëmë të qartë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
2 nuk është e nevojshme që të flas unë për juve.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] E di që ju flisni më mirë se mua,
4 gjykatës.

5 Megjithatë dua që të trajtoj dy çështje. Së pari ajo
6 çfarë po themi neve që deklarata 154 është 100 për qind
7 deklarata që duhet të pranojmë. Megjithatë Prokuroria beson që
8 ka pjesë materiale të deklaratës të cilat çojnë në diskreditim
9 dhe që kërkojnë pranimin e këtyre.

10 Për shembull, në qoftë se unë do të thërras një dëshmitar
11 *viva voce* duke e ditur që dëshmitari nuk do thotë të vërtetën,
12 unë nga aspekti etik nuk duhet fare që ta paraqes atë
13 dëshmitar, pavarësisht që bëhet fjalë për dëshmitarin sipas
14 rregullës 154 ose *viva voce*. Në qoftë se ti e di që
15 informacioni që do japë dëshmitari është i rremë nga elementi
16 ose nga qasja etike unë nuk duhet fare që ta thërras një
17 dëshmitar të tillë për të dhënë dëshmi. Kështu që në këtë
18 situatë duhet që të tërhiqet zbatimi i rregullës 154 dhe të
19 vazhdohet me pyetjen e këtij dëshmitari *viva voce*.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Do të mundohemi që të t'i japim një zgjidhje dhe do të japim
22 një urdhër lidhur me këtë çështje më vonë sot.

23 Mendoj që ka ardhur koha që të vazhdojmë me dëshmitarin.

24 Znj. Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

25 Edhe sa kohë ju duhet, z. Misetic?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Planifikoj Rreth një orë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
4 z. Dëshmitar. Sot do të Vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj
5 që ju lutem dëgjoni pyetjet dhe jepuni përgjigje pyetjeve,
6 jepini përgjigje të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e
7 kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i kërkonit Avokatit që ta
8 përsërisë dhe një herë pyetjen ose thoni që nuk e kuptoj dhe
9 ata do ta sqarojnë.

10 Po ashtu thoni cila është baza e njohurive, fakteve dhe
11 rrethanave për pyetjet që do t'ju bëhen.

12 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrimin për të thënë të
13 vërtetën sikurse është deklaruar në betimin solemn tuajin.

14 Po ashtu mos harroni që të flisni pranë mikrofonit dhe të
15 bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara sesa të jepni
16 përgjigje, në mënyrë të tillë që t'ju ndjekin përkthyesit.

17 Nëse keni nevojë të bëni pushime mund të e thoni dhe ne
18 do të bëjmë organizimet përkatëse.

19 Jeni gati për të vijuar më tej, Dëshmitar?

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 vazhdoni, z. Misetic.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

24 DËSHMITARI: NUREDIN ABAZI [Vijon]

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

1 [Vazhdim]

2 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Sot dua të filloj duke ju pyetur
3 që të na ndihmoni që të kuptojmë një pjesë të intervistës që i
4 keni dhënë ZPS-së, do të paraqes në ekran këtë pjesë të
5 intervistës tuaj.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar i seancës, është prova
7 materiale p01136.3, faqja 17, rreshti 8 në shqip -- jo, ju
8 kërkoj ndjesë. Faqja 8 është në anglisht dhe faqja 20, rreshti
9 17 në versionin në shqip. Kalojmë deri në fund të faqes tek
10 versionin në shqip.

11 PY. Dëshmitar, duke filluar nga rreshti 17, unë do t'ju lexoj
12 pyetjen dhe dua që t'ju kërkoj që të thoni me zë përgjigjen që
13 keni dhënë juve në shqip mbasi të mbaroj unë me pyetjen:

14 "Çfarë roli, për shembull, mund të ketë pasur ky Shtabi i
15 Përgjithshëm në Kleçkë në lidhje me ndonjë supozim apo dyshim
16 që kishte të bënte me ndonjë rast të caktuar. A ka pasur rol
17 ai shtabi në raste të dyshimta".

18 Ju lutem tani thoni me zë të lartë përgjigjen që keni
19 dhënë, lexojeni përgjigjen që keni në ekran.

20 Atëherë pyetja është kjo.

21 "Çfarë roli, për shembull, mund të ketë pasur ky Shtabi i
22 Përgjithshëm në Kleçkë në lidhje me ndonjë supozim ose dyshim
23 që kishte të bënte me ndonjë rast të caktuar?"

24 Ju lutem, lexoni me zë përgjigjen që keni dhënë duke
25 filluar nga rreshti 21 i dokumentit që keni përpara,

1 Dëshmitar?

2 PË. "Jo. Ka qenë më së pari, ai thënë, batalioni, e tërë
3 brigada, e tërë zona, tani është Shtab i Përgjithshëm, kjo
4 është zinxhirë".

5 S'ka kurrfarë kuptimi këtu. Ja paskan hup kuptimin.

6 PY. A je në gjendje që të na thoni se kur flisni për Shtabin
7 e Përgjithshëm këtu për kë Shtab të Përgjithshëm e ke pasur
8 fjalën?

9 PË. Unë e kam pas fjalën për shtabin e batalionit ku kam
10 fillue në Budakovë.

11 PY. Pra, këtu e keni pasur fjalën për Shtabin e Përgjithshëm
12 fare, domethënë, të UÇK-së apo shtabin e përgjithshëm të
13 batalionit, për kë e keni pasur fjalën, na e sqaroni edhe
14 njëherë?

15 PË. Për shtabin e përgjithshëm të batalionit të Budakovës,
16 shtabin numër 1.

17 PY. Në rregull. Faleminderit. Tani do të kaloj në një temë
18 tjetër, ka të bëjë me çështjen e gjykatës ushtarake. Kur keni
19 qenë pjesë e Batalionit 2 në Budakovë a ka pasur profesionistë
20 të tjerë ligjorë ose juridikë përveç jush aty?

21 PË. Jo, z. Avokat.

22 PY. A ka pasur ndonjë person tjetër përveç jush që ka pas
23 diplomë juridiku, ka pas mbaru studimet e larta për juridik
24 përveç jush aty?

25 PË. Sa di unë jo.

Dëshmitari: Nuredin Abazi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 17

1 PY. Pra, mesa dini ju batalioni a është mbështetur tek ndonjë
2 person tjetër, veç jush, sa i takon këshillimeve juridike ose
3 sa i takon hartimit të dokumenteve juridike apo rregulloreve
4 të ndryshme të kësaj natyre?

5 PË. Sa di unë, jo.

6 PY. Në batalionin tuaj a keni pasur ndonjë gjykatë ushtarake
7 ju?

8 PË. Gjykatë ushtarake s'ka pas kurrkund jo veç në batalion.

9 Unë s'kam dëgju fare që ka pas kund gjykatë ushtarake as sot
10 nuk ka gjykatë ushtarake pas 25 vjetësh.

11 PY. Pra, nuk ke dëgjuar ndonjëherë që ka pasur gjykatë
12 ushtarake të krijuar në nivel brigade, në nivel zone apo në
13 nivel të përgjithshëm të Shtabit të Përgjithshëm, kështu
14 Dëshmitar?

15 PË. Jo, s'kam dëgjuar e as besoj që ka pas.

16 PY. Në rregull. A ju kujtohet që kur jeni takuar me
17 Prokurorin, Prokurori ju ka treguar një libër të Ilaz Kadollit
18 që quhet "Syri i Shqiponjës".

19 PË. Po, atë ditë e kam pa për herë të parë.

20 PY. A e dini kush është Ilaz Kadolli?

21 PË. Po.

22 PY. A keni pas kontakte me të gjatë luftës?

23 PË. Kam pas rrallë.

24 PY. A ju kujtohet në një kohë konkrete kur jeni takuar me
25 Ilaz Kadolli gjatë luftës?

1 PË. Nuk më kujtohet, po kemi pas kontakte.

2 PË. Do t'ju tregoj disa fragmente nga libri i Ilaz Kadollit.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
4 paraqesë në ekran provën materiale 12 në faqen 058009 në
5 anglisht dhe të njëjtën faqe dhe në versionin në shqip. Ju
6 lutem ta zmadhoni pak atë fragmentin, paragrafin që thotë
7 "Gjykata Ushtarake"

8 PY. Dëshmitar, unë do t'ju lexoj çfarë ka thënë z. Kadolli.

9 Thotë:

10 "Në fillim të marsit 1999, baza ... njësitit Syri i
11 Shqiponjës është zhvendosur nga shtëpia e Ilmaz Popaj nga
12 Vneshta në shatin Kastër të Terandës, rreth 100 metra pranë
13 shtabit të zonës operative të Pashtrikut. Njëri nga ushtarët
14 në rejë më njoftoi se më kërkonte një epror nga Shtabi i
15 Përgjithshëm. E pyeta kush ishte. Më tha ... se ishte një burrë
16 i moshuar ... që quhej Baca Kolë. Baca Kolë quanim Sokol
17 Dobrunën nga Gjakova".

18 E shihni, dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. E ke njohur Sokol Dobrunën gjatë luftës?

21 PË. Jo. Një herë veç kemi pas një udhëtim me të. Kurrë s'e
22 kam njoft.

23 PY. Kur ka ndodhur?

24 PË. Ka ndodhë në 1999.

25 PY. Të kujtohet në cilin muaj?

1 PË. Po dikund nga muaji maj mund të jetë.

2 PY. A të kujtohet pse udhëtuat bashkë?

3 PË. Na ka rastis puna. Kemi kemi qenë duke shku dikun edhe
4 jena taku.

5 PY. A të kujtohet ku po shkonit?

6 PË. Jo, s'ka qenë me rëndësi. Nuk ka qenë me rëndësi
7 udhëtimi.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

9 PY. Te paragrafi i dytë thuhet:

10 "Kola më njoftoi arsyen e ardhjes në zonën operative të
11 Pashtrikut, përkatësisht takimin me mua dhe se ishte caktuar
12 që të shtrinte degët e kësaj gjykate në të gjitha zonat
13 ushtarake. Në fillim, do të vepronin si shërbime juridike,
14 ndërsa aty ku kishe kushte dhe si gjykatë dhe do të ishin të
15 lidhura me qendrën në Shtabin e Përgjithshëm. Kola më bëri të
16 ditur se unë isha caktuar të organizoja gjykatën ushtarake në
17 zonën operative të Pashtrikut. Ndërsa urdhëresa do të më vinte
18 më vonë përmes korrierëve. Baca Kolë më kishte parasysh për
19 shkak të njohjes ë më hershme të profesionit tim jurist.
20 Biseduam dhe për ushtarët e tjerë që mund të shërbenin në
21 gjykatën ushtarake. U përmendën emrat e juristëve si Nuredin
22 Abazi, Emri Gashi dhe të tjerë, me të cilët në fillim do të
23 formohej shërbimi juridik në kuadër të zonës, ndërsa më vonë
24 edhe vetë gjykata ushtarake".

25 E shihni, Dëshmitar, këtë pjesë?

1 PË. Po, e shof.

2 PY. Ju kontaktuan ndonjëherë që të shërbenit si jurist pranë
3 gjykatës ushtarake?

4 PË. Jo, asnjëherë.

5 PY. Thatë që, mesa keni ju dijeni, nuk u krijua ndonjëherë
6 ndonjë gjykatë ushtarake. A keni ndonjë arsye, a mund të na
7 jepni ndonjë shpjegim pse nuk mund të krijohet një gjykatë
8 ushtarake?

9 PË. Asnjëherë nuk ka pat gjykatë ushtarake, as që është
10 krijuar ndonjëherë ndonjë gjykatë ushtarake, sa di unë.
11 Gjykatë ushtarake nuk ka pas kërrkund në Kosovë pasi që për
12 themelimin e një gjykate ushtarake janë dashtë kushte të
13 veçanta të cilat atëherë na kanë munguar. Dhe kemi qenë të pa
14 zotë ta krijojmë një gjykatë të tillë pasi që ofensivat nuk na
15 kanë lënë me çu kokën të kemi mëndu diçka rreth asaj, përveçse
16 me u mbrojt dhe me marrë pjesë në aksione.

17 Gjykatë ushtarake edhe sot nuk ka mbas 25 vjet luftë mbas
18 25 vite paq nuk jemi tuj mujt me themelu gjykatën ushtarake e
19 le më atëherë në kushte të luftës. Dhe prapë po e cekim, sa di
20 unë, kurrë nuk kam ni për gjykatë ushtarake dhe as që ka pas
21 gjykatë ushtarake.

22 Në qoftë se po ditka Ilaz Kadolli ose baca Kolë, mundet
23 me i pyet ata. Unë as qet dokument s'e kam pa kurrë, qet libër
24 që e ka shkru Ilaz Kadolli. Për herë të parë e kam pa para një
25 jave Prokurori kur ma ka prezantë. Ambiciet kanë qenë, me

1 siguri, po them pasi që e ka shkruar në libër, por dëshirat
2 janë tjera mundësitë janë tjera. Kurrë nuk përshtaten dëshirat
3 dhe mundësitë. Aty është një hendek shumë i madh, unë mendoj.
4 PY. Thoni që ka qenë ambicia. Aso kohe e keni dit ju që ka
5 patur një ambicie për të krijuar një gjykatë ushtarake?

6 PË. Po ambiciet i kemi pas nga që do të çlirohemi dhe do të
7 bëjmë punë shumë ë të mëdhaja por kemi bë aq sa kemi mujt kemi
8 bë. Normalisht çdo luftëtar ka ambicie që ta çliroj vendin një
9 këmbë e më para dhe ti ka strukturat të gjitha çka i nevojiten
10 një ushtrie.

11 PY. Po pyetja ime është më konkrete. Do ta riformuloj. A të
12 kujtohet ndonjëherë të jetë bërë ndonjë diskutim në ndonjë
13 moment gjatë luftës për themelimin e ndonjë gjykate ushtarake?

14 PË. Jo.

15 PY. Tani do t'ju pyes lidhur për dëshminë lidhur me policinë
16 ushtarake. I thatë ZPS-së - kjo është në intervistën tuaj me
17 ZPS-në Pjesa 1, fillon në faqen 31 në anglisht. Thatë që mesa
18 keni ju dijeni, me aq sa dinit ju, e gjithë policia ushtarake
19 ishte pjesë e batalionit në verën e 1998, ishte pjesë e
20 strukturës së batalionit në verën e 1998?

21 Do ta bëj dhe një herë në fakt pyetjen. Policia ushtarake
22 që ka qenë me ju në batalion, sipas jush, ishte pjesë e
23 strukturës së batalionit?

24 PË. Po atëherë policia ushtarake ka qenë një skuadër e
25 veçantë që na e kemi pas quajjt për intervenime të shpejta për

1 atë edhe e ka marrë emrin si polici ushtarake. Ajo ka qenë e
2 përgatitur për intervenime të shpejta që u dashtë aty për aty.

3 PY. Dakord po pyetja ime është kjo: Kujt i raportonin? I
4 raportonin komandantit të batalionit apo tjetërkund?

5 PË. Nuk kam ide. Nuk kam ide.

6 PY. Pjesëtarët e policisë ushtarake, mesa keni ju dijeni,
7 ishin stërvitë?

8 PË. Po ata kanë qenë pak ma të përgatitur se ushtarët tjerë.

9 PY. Kush i ka stërvitur?

10 PË. Po vetë janë stërvit ata. E kanë pas një udhëheqës që i
11 ka stërvit dhe i ka ushtru për intervenime të shpejta.

12 PY. Udhëheqësi i tyre ka qenë Musë Kololli, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Po atyre u jepje këshilla ligjore se si të silleshin me
15 civilët?

16 PË. Po.

17 PY. Të kujtohet ndonjë rast konkret kur u ke dhënë ndonjëherë
18 këshilla ligjore si të trajtonin civilët dhe ku ka ndodhur
19 kjo?

20 PË. Po na kemi qenë në batalionin e Budakovës dhe na jemi
21 takue shpesh aty. Dhe gjithë herët kur jemi taku kemi
22 bashkëbisedu lidhur me mirësjelljen, rregulloren, çka me bë,
23 qysh me u sjellë me ushtarët, qysh me u sjellë me civilë. Qëto
24 kanë qenë kryesisht.

25 PY. Sa i takon Musë Kolollit keni dijeni kush e ka emëru Musë

1 Kolollin në pozitën e tij si komandant i policisë ushtarake në
2 batalionin tuaj?

3 PË. Për nder nuk kam ide kush e ka emnu por e di që Musë
4 Kololli ka qenë më i përgatitun, ka qenë në moshë ma i vjetër
5 dhe ka pas një përparësi që ka punu edhe para luftës në
6 polici. Ka qenë në ish-policinë jugosllave, kështu që ka pas
7 njohuri më të mëdhaja se të tjerët. Ka qenë i Budakovës aty
8 vendas. E ka njoft edhe terrenin më mirë se tjerët.

9 PY. Lidhur me këtë pikë desha t'ju pyes, Musë Kololli ka qenë
10 pjesë dikur e policisë jugosllave, ish-anëtar i policisë
11 jugosllave?

12 Do t'ju ndihmoj pak me kujtesën. Unë sot po përpiqem t'ju
13 ndihmojë kush e ka emëruar.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, nuk besoj se
15 dëshmitari u përgjigj ose të paktën nuk u zbardh në
16 transkript.

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, do të duhet ta përsëris pyetjen sepse duhet të
19 zbardhet në transkript, duhet të paraqitet në transkript.

20 Dhe një herë, lidhur me Musë Kolollin. Musë Kololli ka
21 qenë ish-polici i policisë jugosllave kështu?

22 PË. Po e thashë.

23 PY. Në rregull. A keni biseduar ndonjëherë apo ju kujtohet të
24 keni biseduar ndonjëherë me Musë Kolollin mos kishte ndonjë
25 informacion ai për personat që dyshoheshin si kolaboracionistë

1 duke marrë parasysh rolin e tij të mëparshëm në policinë

2 jugosllave?

3 PË. Jo, z. Avokat.

4 PY. Tani sa i takon emërimin të tij. Kemi provën materiale

5 P1136.1, në faqen 31 në anglisht. Do ju lexoj pyetjen dhe

6 përgjigjen që keni pas me ZPS-në. Pyetja ka qenë kjo:

7 "A e dini kush e ka emëruar si komandant të policisë

8 ushtarake?"

9 Dhe ju jeni përgjigjur:

10 "Të gjithë janë emëru nga komandanti".

11 Ju ndihmon kjo që t'ju kujtohet kush ju e ka emëruar Musë

12 Kolollin?

13 PË. Ndoshta mund të jetë ashtu. Ndoshta, s'e di. Mund ta

14 pyetni atë. Çka s'di me siguri nuk muj me thanë.

15 PY. Në rregull. Por komandanti që thoni ju këtu, kur i

16 referoheni komandantit e keni fjalën për Sadik Halitjahën?

17 PË. Po.

18 PY. Ushtarët e tjerë e respektonin Musë Kolollin?

19 PË. Po normalisht të gjithë jemi respektu mes veti, jo vetëm

20 Musën.

21 PY. A keni ide pse e respektonin?

22 PË. Se pikë së pasi ka qenë më i vjetër në moshë. Ka qenë

23 shumë i sjellshëm dhe i kuptueshëm. Ka qenë person më i

24 ngritun profesionalisht. Dhe e kanë vlerësu edhe si udhëheqës

25 të policisë.

1 PY. A të kujtohet nëse ka pasur ndonjë person që kishte
2 dyshime për të për faktin se kishte qenë pjesë e policisë
3 jugosllave?

4 PË. Jo, kurrë.

5 PY. Dëshmitar, a është e vërtetë që s'jeni takuar asnjëherë
6 me Hashim Thaçi apo me ndonjë pjesëtar tjetër të Shtabit të
7 Përgjithshëm gjatë luftës?

8 PË. Jo, kurrë s'jam taku. S'besoj as që më njofin as ata mua.
9 Në televizor që i kam pa mbas luftës.

10 PY. A të kujtohet nëse anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm
11 takoheshin me komandantët e zonës?

12 PË. Unë nuk e di. Sigurisht duhet me i vetë komandantët e
13 zonës. Pse mu po më pyetni për këtë?

14 PË. Në atë kohë e keni ditur ju çfarë roli apo çfarë detyrash
15 kishte z. Thaçi gjatë luftës?

16 PË. Po ka qenë staf politik, udhëheqës politik i UÇK-së.

17 PY. E keni ditur këtë që gjatë luftës?

18 PË. Po.

19 PY. Po këtë e keni ditur mbase për shkak të negociatave të
20 Rambujesë?

21 PË. Patjetër.

22 PY. Tani do të doja që të fokusoheshim në një temë tjetër.

23 Kur keni shërbyer në batalionin tuaj në Budakovë, a keni
24 trajtuar çështje të ndalimit?

25 PË. Nuk kemi pas çështje të ndalimit ne asnjëherë. Kemi pas

1 çështje të legjitimitit, gjegjësisht identifikimit të
2 personave të cilët kanë hyrë në zonën e luftës edhe kurrëgjë
3 tjetër.

4 PY. Kur thoni identifikim i personave që hynin në zonën e
5 luftës, mund të na e shpjegoni pak më shumë? Domethënë, e
6 kishit ju për detyrë si këshilltar ligjor të identifikoni
7 personat që hynin në zona lufte?

8 PË. Jo, z. Avokat. Për detyrë e ka pas roja që e ka përkufizuar
9 zonën. Ata kanë pas për detyrë me i identifikuar kush po hynë në
10 zonë edhe kush po del, jo unë.

11 PY. Për shembull, do t'ju bëj një pyetje kështu, nëse mbahej
12 i ndaluar një ushtar i UÇK-së për çështje disiplinore, shkelje
13 të disiplinës, këtë ushtar kush e merrte në pyetje?

14 PË. Nuk e kam marrë në pyetje. Po kam bashkëbiseduar me të,
15 unë.

16 PY. Por për çfarë qëllimi flisnit me ta? Cili ishte
17 objektivi?

18 PË. Objektivi ishte gabimi që kishte bërë ai, që ka shkel
19 diçka çka s'është dashtë me bë, një veprim jonjerëzor, një
20 veprim jo të duhur.

21 PY. Dhe pasi bisedohej me të, çfarë bëhej, çfarë bëhej në
22 vijim të bisedës me këtë person? Ia raportojë dikujt?

23 PË. Po në qoftë se ka pas nevojë i raportojë komandantit.
24 S'ka pas nevojë ka qenë shkelje e vogël ia kemi dhënë një
25 vërejtje ose një roje jashtë orarit dhe ka përfunduar me kaq.

1 Kaq s'kemi pas tjetër sen çka me ba.

2 PY. Kur thoni komandant e keni fjalën për Sadik Halitjahën?

3 PË. Po.

4 PY. ZPS-ja ju pyeti e çështjen e Latife dhe Rushe Kolollit.

5 Ju kujtohet?

6 PË. Po.

7 PY. Këto dy gra nuk i ke njohur më përpara deri në momentin

8 që i sollën në batalionin tuaj kështu?

9 PË. Jo, kurrë s'i kam njoft, as kurrë s'i kam pa.

10 PY. Dhe nuk ka qenë kompetencë e juaj të urdhëronit ndalimin

11 e tyre, kështu?

12 PË. E thashë edhe më parë. S'e di sa më kuptuat, z. Avokat.

13 Unë nuk ndaloj askënd, as kam ndalu. Ju shpjegova unë, ju

14 shpjegova, po ju s'e di a e kuptuat apo doni prapë përsëri me

15 jua përsërit pyetjen.

16 PY. E kuptoj. E kuptova. Po duhet, po përpiqem të kuptoj kush

17 i ka ndaluar dhe mesa po kuptoj unë nga dëshmia juaj, sa kam

18 kuptuar nga dëshmia juaj, ato i ka sjellë Musë Qerkini,

19 kështu?

20 PË. Po, z. Avokat

21 PY. Dhe nga sa kuptoj unë nga dëshmia juaj, ju nuk jeni i

22 sigurt nëse ato kanë ardhur aty me urdhër të Sadik Halitjahës,

23 saktë?

24 PË. Po Sadik Halitjaha s'i ka njoft fare ato. Ku ka pas mund

25 me njoft Sadik Halitjaha kur Sadiku ka ardhë pej Zvicrës s'i

1 ka njoft as 10 për qind të popullatës. 15 vjet në Zvicër ka
2 qenë pa ardhë hiç.

3 PY. Në shënimin përgatitor që keni pasur me Prokurorinë javën
4 e kaluar, është Shënimi Përgatitor 1, ju keni thënë:

5 "Mund të ketë qenë Sadik Halitjaha që ka nxjerrë urdhrin
6 për transferimin e këtyre dy grave por ju nuk e dini nëse e ka
7 lëshuar Sadik Halitjaha këtë urdhër, atë mund ta dinë personat
8 që i transportuan këto gratë".

9 Kështu?

10 PË. Ashtu është.

11 PY. Dhe në një moment ju biseduat me këto gratë, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Pse vendosët të flisnit me to?

14 PË. Se i kanë sjellë aty si të dyshimta.

15 PY. Kush e vendosi që ishin të dyshimta?

16 PË. Po personat që i kanë legjitimu. Gjegjësisht Musë
17 Qerkini.

18 PY. Po a të thanë për çfarë ishin të dyshuara?

19 PË. Po. Mendoj se kanë bashkëpunu me policinë serbe. I kanë
20 pa duke hy edhe duke dalë në stacionin e policisë e qështu me
21 radhë.

22 PY. "Te stacioni i policisë" serbe e keni fjalën?

23 PË. Po.

24 PY. A mund të na e shpjegoni pse ishte i dyshimtë kjo?

25 PË. Pse ishte gjendje lufte. Na luftë kishim me stacionin e

1 policisë me ushtrinë e Serbisë. Bashkëpunimi me ta ka qenë i
2 palejueshëm, i parregullt, i pamoralshëm. Gjendje lufte.

3 PY. E kuptoj unë këtë pjesë. Apo a mund t'i shpjegoni Trupit
4 Gjykues pse ishte e dyshimtë që një shqiptar të hynte në një
5 stacion të policisë serbe?

6 PË. Nuk kuptoj çfarë po mendoni ju. Në kohë të luftës me hi
7 me bashkëpunu me okupatorin që po të vret qenka krejt normale?
8 A mendoni ashtu?

9 PY. Jo. Unë e kuptoj punën e kolaboratorit. Do ta bëj dhe një
10 herë pyetjen. Nga e dinit ju, që një person nuk shkonte në
11 stacion të policisë për të marrë një letërnjoftim a për të
12 raportu një krim, apo për çdo gjë tjetër që mund të shkojë
13 normalisht njerëzit tek stacioni i policisë?

14 Dhe unë prandaj po të them që pse dhe t'ia shpjegoni këtë
15 Trupit Gjykues, pse në atë periudhë kohore konkrete në ato
16 rrethana konkrete konsiderohej veprim i dyshimtë që dikush të
17 shkonte tek stacioni i policisë?

18 PË. Z. Avokat, na i kemi pas ndërpre të gjitha bashkëpunimet
19 me policinë dhe ushtrinë e Serbisë në kohë lufte. Na s'kemi
20 marrë as pasosha, as letërnjoftime, as kurrfarë bisede, as
21 kemi raportu kurrfarë krimi te ata. Ka qenë normale. Si mund
22 të bashkëpunosh me okupatorin ti në kohë lufte? A ju duket kjo
23 normale juve?

24 PY. Kur biseduat me këto gratë për çfarë folët, çfarë i pyete
25 ti dhe çfarë të thanë ato?

1 PË. Na bashkëbisedum me to rreth asaj çka mendohej, po gjatë
2 bisedimeve u konstatu se nuk ka kurrëgjë të dyshimtë. Ato
3 thjesht ishin bërë ato veprime për çështje të ulëta të cilat i
4 kam thënë edhe Prokurorit.

5 PY. Pse shkonin te stacioni i policisë?

6 PË. Nuk e di unë.

7 PY. Po nëse i sollën për shkak të dyshimit se kishin shkuar
8 tek stacioni i policisë, ju duhet t'i keni pyetur pse shkonin
9 ato tek stacioni i policisë?

10 PË. Po unë i kam pyetur ato po ato janë kanë laike q'aq sa
11 s'kanë pas as shkollën fillore s'kanë pas të kryme edhe kanë
12 qenë pak a shumë të etiketume prej rrethit ku kanë jetue ato.
13 Kështu që krejt ato kanë qenë fjalë boshe, fjalë të pakuptimta
14 dhe ato s'i kanë kuptu as vetë veprimet e veta që i kanë bërë.

15 PY. A mësove ndonjëherë edhe pse kishin arsim aq të ulët, me
16 gjithë arsimit shumë të ulët që kishin ato, a e zbulove në
17 ndonjë moment pse shkonin te stacioni i policisë?

18 PË. Jo. Nuk kam mund me e zbulue se s'ka pas kurrfarë
19 lidhshmërie bisedat e tyre s'janë lidhë kurrfarë, kurrsesi me
20 asgjë, po mendoj, të ndalume. Vetëm për çështje morali ka
21 qenë, çështje të ulta të moralit.

22 PY. I thatë ZPS-ja që keni qëndruar me gratë që të
23 garantoreshit që nuk do t'i lëndonin, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Tregoji Trupit Gjykues pse kishe merak ose pse dyshoje që

1 mund të lëndoheshin?

2 PË. Çka është ky merak? S'po di çka ai merak. S'kam pas merak
3 fare me bisedu me kërrkënd. Vetëm kam pas frikë mos po i
4 maltraton dikush edhe mu për atë kam qëndru me to.

5 PY. Po, në fakt, kjo ishte pyetja ime. Pse mendoje ti që ato
6 mund të maltratoheshin?

7 PË. Kisha frikë se ushtarët ishin të rinj, ushtarë të
8 papërvojë. Me thashetheme të ndryshme që kanë dëgju prej
9 qytetarëve mund të ndodhte diçka. Kështu që s'i kam lënë vetë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, ky mund të
11 jetë momenti më i volitshëm për të bërë pushimin.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa kohë
13 mendoni se ju nevojitet?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe dhjetë minuta.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
16 vazhdoni përfundoni ju dhe pastaj e bëjmë pushimin.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] në rregull.

18 PY. Dëshmitar, këta ushtarë që ju thatë se ju kishit frikë se
19 mund të merrnin masa kundër këtyre grave, a kishte ndonjë
20 arsye që, për shembull, një urdhër nga Sadik Halitjaha mund
21 t'i kishte ndaluar këta ushtarë të bënin ndonjë gjë kundër
22 këtyre grave ose të merrnin ndonjë masë kundër këtyre grave?

23 PË. Po Sadik Halitjaha nuk ka pas njohuri për të gjitha
24 cikërrimet që kanë ndodhur në batalion. Batalioni ka pasur
25 edhe punë të tjera më të mëdhaja, nuk ka pas veç -- ka pas

1 edhe organizime tjera rreth luftës, rreth mbrojtjes, rreth
2 furnizimit me ushqime, furnizimit me armë. Të gjitha këto janë
3 kanë në përgjegjësinë e komandës së batalionit. S'e ka pas ai
4 të folim rreth një ushtari çka po bën ose një qytetari çka
5 flitet për të. Këto kanë qenë punë shumë të imta.

6 PY. Pasi patët këtë bisedë me këto gra, a raportuat lidhur me
7 gjetjet ose konstatimet tuaja pas bisedës a i raportuat Sadik
8 Halitjahës lidhur me këtë?

9 PË. Jo, s'ka pas nevojë me raportu. S'ka pas kurrfarë nevoje.

10 PY. Ju bëra një pyetje para pak minutash se cilat ishin
11 detyrat tuaja dhe ju pyeta që në qoftë se një ushtar do të
12 ndalohej për shkak të shkeljes së disiplinës, ju thatë që
13 bënit një bisedë me të dhe konstatimet tuaja ia raportoni
14 komandantit. Dhe në këtë rast konkret unë dua të di që
15 parashtrime, konstatimet apo ato gjërat që ju vutë re gjatë
16 bisedës, pse nuk ia raportuat komandantit?

17 PË. Po ato gjithherë nuk kemi mujt me kontakt me komandantin
18 se ai ka qenë i zënë edhe me detyra tjera shpesh ka munguar
19 nga brigada. Shpesh ka qenë e panevojshme. Kështu që disa
20 gjëna nuk kam mujt me i raportu, kanë kalu ashtu të
21 parëndësishme.

22 PY. Nëse ju arritët në përfundimin që nuk kishte arsye që
23 ato të vazhdonin të mbaheshin të ndaluara, kujt ia keni dhënë
24 këtë përfundim tuajin në mënyrë të tillë që të sigurohej
25 pastaj lirimi i grave?

- 1 PË. Po kam bisedu me Agimin dhe me Naimin, Naim Kadollin.
- 2 PY. Çfarë ju the ti këtyre dy personave?
- 3 PË. Ju thashë që këto dy femra duhet të lirohen se s'ka asgjë
4 kontestuese pi këto, nuk ka asgjë të ndaluar shka i përket
5 bisedimit që kam konstatuar unë gjatë bashkëbisedimit me to.
6 Krejt ishin ato çështje të ulta të cilat nuk ia vlente as me
7 diskutu për to, çështje morale që edhe nuk ia vlejné me
8 përmend. I thashë se ishin për çështje morali.
- 9 PY. Agim Zyba dhe Naim Kadolli ishin pjesëtarë të batalionit
10 tuaj?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. A i morën ata gratë, i liruan?
- 13 PË. Nuk e di unë. Unë i kam propozu me i liru. Ma tutje nuk
14 di.
- 15 PY. A e dini nëse Agim Zyba dhe Naim Kadolli i kanë shoqëruar
16 këto dy gra në ndonjë vend tjetër?
- 17 PË. Mund t'i pyetni ata. Unë nuk di më tutje.
- 18 PY. A jeni në dijeni që trupat e këtyre dy grave më vonë janë
19 gjetur n rrugën kryesore ndërmjet Prizrenit dhe Suharekës?
- 20 PË. Jo. Unë kam kuptue tek mbas luftës se ato janë gjend me
21 një udhëkryq, në cilin udhëkryq vazhdimisht patrullonin
22 policia dhe ushtria e Serbisë me autoblanda.
- 23 PY. Nuk e dini ju, apo jo, se kush i ka vrarë këto gra, është
24 e saktë?
- 25 PË. Jo, jo. Unë e besoj që i kanë vra forcat serbe se e

1 pamundur ka qenë aty me hi na si ushtri se ka qenë vendi tejet
2 i rrezikshëm. Ku janë gjend trupat e atyre, mbas luftës kur e
3 kam dëgjues, ka qenë tejet e rrezikshme aty me u afru ne. Se
4 ai vend ka qenë gjithmonë i mbulu me autoblinda dhe tanke të
5 Serbisë.

6 PY. Për çfarë zone e keni fjalën konkretisht, për çfarë vendi
7 e keni fjalën?

8 PË. Po sa di unë ato janë gjet afër Leshanit, në rrugën
9 kryesore që shkon për Suharekë-Prizren, është rruga që ndahet
10 për fshatin Leshan, aty është një farë udhëkryqi, një farë si
11 ishulli. Qaty kam dëgju që janë gjet. Nuk di saktësisht. Krejt
12 me të ndëgjune po e them, se nuk i kam parë as s'i kam --

13 PY. A po thoni se kjo zonë ka qenë nënkontrollin e serbëve në
14 gusht të 1998?

15 PË. Patjetër. 100 për qind. Edhe rruga e asfaltune Prizren-
16 Suharekë gjithmonë ka qenë në kontrollin e tyre.

17 PY. A e dini sesi mund të kishin përfunduar, sesi mund të
18 kishin shkuar ato në territor serb pasi u mbajtën nga Agim
19 Zyba dhe Naim Kadolli, e kam fjalën, për këto dy gratë?

20 PË. Nuk e di. S'kam njohuri.

21 PY. Dëshmitar, kam edhe disa pyetje të tjera që ka të bëjnë
22 me Fetah Rudin. A ju kujtohet të keni biseduar për rastin e
23 Fetah Rudit me ZPS-në?

24 PË. Po.

25 PY. A jeni takuar me Fetah Rudin gjatë luftës ose menjëherë

1 pas luftës?

2 PË. Gjatë luftës jam takuar me Fetah Rudin një herë. Një
3 herë.

4 PY. Kur jeni takuar ekzaktësisht gjatë luftës?

5 PË. Ai ka qenë 1998. Si më duket në 1998. Po.

6 PY. A ju kujtohen rrethanat me të cilat jeni takuar me Fetah
7 Rudin?

8 PË. Po. Ka pas një aferë se gjoja Fetah Rudi është duke i
9 keqpërdorë ndihmat ushqimore të cilat janë sjellë nga
10 fondacioni Nëna Terezë për mbajtjen e popullatës. Aty ka pas
11 ushqime të ndryshme mill, vaj, sheqer, e tjera. Dhe ky si
12 udhëheqës i fshatit i ka pas në menaxhim ato dhe e ka pas për
13 detyrë për me i nda popullatës në mënyrë proporcionale. Për
14 shkak të dyshimit se ato nuk janë nda mirë nga Fetah Rudi kanë
15 lind tëna dyshimet. Dhe për këtë kam biseduar me të, kam
16 bashkëbiseduar dhe e kemi zgjidh këtë problem.

17 PY. Kush ju kërkoj juve që të flisni me të?

18 PË. Më ka kërku komandanti, Sadik Halitjaha.

19 PY. A është e mundur që kjo të ketë ndodhur në 1999 dhe jo në
20 1998?

21 PË. Nuk besoj, po s'jam i sigurt. Unë e di që 1998.

22 PY. Në rregull. A ju kujtohet se Sadik Halitjaha ju ka thënë
23 që ekzistonte dyshimi që ai ishte i përfshirë në spiunazh?

24 PË. Ka pas thashetheme po nuk kanë qenë të vërteta ato fare.

25 S'kanë qenë të vërteta.

1 PY. Mirë. Po pavarësisht kësaj Sadik halitjaha a jua ka
2 përsërit këtë thashetheme me juve, jua ka thënë këto
3 thashetheme me juve?
4 PË. Po jo, ato kanë qenë popullata aty që ka jetu dhe vepru
5 popullata ashtu e kanë konsiderue. Gjatë bashkëbisedimit ata
6 kanë konstatu se ai ishte njeri i ngritur, njeri i përcaktuar
7 për Rugovën, për atë nuk ka pasur aty kurrfarë dileme tjetër.
8 Me Rugovën nuk kemi qenë armiq. Ai ka pas teorinë e vet të
9 qëndresës me paq, arritjen e synimeve me paq. Ndërsa ne kemi
10 pas tjetër qëndrim, kemi pas drejtimin tonë, që kemi menduar
11 që liria nuk fitohet pa luftë edhe e kemi përkrah luftën. Duke
12 parë se dhjetë vjet bisedime nuk u arrit asgjë vetëm
13 përkundrazi shkojke duke u prish situata edhe ma tepër duke
14 acaruar, duke ik njerëz prej vendit, duke keqtrajtuar, vrarë,
15 maltratuuar në forma të ndryshme. Disa marrëveshje u arritën me
16 Rugovën atëherë se mbaj mend me [E pakuptueshme], ato s'u
17 respektuan fare. Kështu që popullata u irritua dhe mori vendim
18 që të organizohet në rezistencë, se me paq s'kishte asgjë dhe
19 s'kemi besu që do të arrihet diçka. Kjo ishte krejt.

20 Ndërsa sa i përket Fetah Rudit, me Fetain kam bisedue në
21 mënyrë korrekte. Edhe pas luftës ai bile me një artikull në
22 gazetë është falënderuar për mirëkuptimin që kemi pas dhe që
23 kam bisedu me të, përmes gazetës është falënderu. Është edhe
24 artikulli në gazetë.

25 PY. Gjatë bisedës a diskutuat me të lidhur me thashethemet që

1 qarkullonte se ai ishte i përfshirë në spiunazh?

2 PË. Po, kemi bisedu, por s'kanë qenë të vërteta ato. Sipas
3 mendimit tem s'kanë qenë të vërteta. S'ka pas gjë të vërtetë.

4 PY. Në rregull. Kur e keni diskutuar, kur e keni biseduar me
5 të, a ju kujtohet se çfarë ju ka thënë ai në përgjigje të
6 kësaj bisede?

7 PË. Po normalisht ai i ka mohuar ato dhe qashtu kanë dalë. Ai
8 ka thënë se e ka ideal Ibrahim Rugovën edhe s'ka pas kurrëgjë
9 të keqe.

10 PY. Ilaz Kadolli a ka qenë i pranishëm kur ka ndodhë kjo
11 biseda?

12 PË. Më duket se po, po ka qenë. Po shumë pak më kujtohet se
13 ka qenë shumë kohë e gjatë. Po, ka qenë edhe Ilazi.

14 PY. A ju kujtohet se pse ka qenë i pranishëm ai?

15 PË. Po ka qenë, ka pas shoqni bashkë me të kemi shku dhe kemi
16 pas si bashkëluftëtarë si njeri që ma tepër i njeh rregullat
17 ligjore, ka qenë jurist edhe kemi vendos që bashkë.

18 PY. Ju ishit këshilltari juridik i Sadik Halitjahës. Po Sadik
19 Halitjaha a i ka thënë edhe Ilaz Kadollit që të ishte bashkë
20 me ju, që të shkonte bashkë me ju?

21 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet.

22 PY. Çfarë roli kishte Ilaz Kadolli sa i takon bisedës me
23 Fetah Rudin?

24 PË. Kurrfarë roli. Thjesht kemi bashkëbisedu me të. Ilazi sa
25 di unë ka qenë diçka për moral, për politikë në brigadë.

Dëshmitari: Nuredin Abazi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 38

1 Tjetër nuk di.

2 PY. A po thoni në dëshminë tuaj se pasi ju dhe Ilaz Kadolli e
3 morët në pyetje e intervistuat atë, Fetah Rudin e liruan, këtë
4 po thoni?

5 PË. Po as nuk i kemi liru, as nuk i kemi ndalu. Na kemi
6 bashkëbisedu. Ai s'ka qenë as i ndalum, as i lirim. Ka qenë
7 qytetar i thjesht. Si ku po e merrni këtë mendimin i ndaluar, i
8 burgosur s'e di qysh. Ai ka qenë në shtëpi të vet. Nuk ka qenë
9 as ushtar.

10 PY. Dëshmitar, po jua bëj këtë pyetje sepse ka prova që ju i
11 keni thënë Fetah Rudit që ai është dënuar në atë bisedë. Dhe
12 thjesht dua t'ju jap mundësinë juve që t'i tregoni Trupit
13 Gjykses në qoftë se kjo është e vërtetë apo jo.

14 PË. Asnjë provë s'është e vërtetë. Këto janë veç gënjeshtër.
15 Kurrë s'a dënu Fetah Rudi. Kurrë.

16 PY. Në rregull. Faleminderit, Dëshmitar.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Dëshmitar, do bëjmë një pushim prej dhjetë minutash tani.
20 Do t'ju shoqërojë asistentja nga Salla. Do takohemi përsëri
21 për dhjetë minuta.

22 DËSHMITARI: Okej.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace.

25 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 Dua që t'ju kërkoj leje, që ne si ZPS të mund të
2 parashtrojmë një parashtrim të shkurtër për sa i takon
3 çështjeve që u ngritën sot më herët paradite, domethënë duam
4 që ta bëjmë këtë deri në orën 4.00 pasdite në qoftë se na
5 jepni leje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Do bëjmë dhjetë minuta pushim tani.

8 --- Seanca ndërpritet në orën 10.17

9 --- Seanca rifillon në orën 10.29

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
11 kishit pyetje?

12 Z. EMMERSON: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju pyes në
14 përgjithësi. Keni pyetje?

15 Z. EMMERSON: [Mikrofoni çaktivizuar] Kam, por shumë pak
16 pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
18 Silleni dëshmitarin.

19 Po ju z. Roberts, do të keni pyetje?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për momentin nuk mendoj se do të
21 kemi pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
23 Alagendr.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Pyetje do të kem po shumë më
25 pak se 45 minuta që kisha thënë fillimisht.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Gjithashtu dua të them që folëm
2 me z. Pace është një person që ka dhënë dëshmi në seancë të
3 hapur në këtë gjyq dhe do ta përmend emrin e këtij personit
4 gjatë kundërpjetje të mia dhe do ta bëj këtë në seancë të
5 hapur se në fund të fundit ky person dëshminë e ka dhënë në
6 seancë të hapur.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
8 që na informuat. Nuk ka kundërshtime.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
11 Dëshmitar. Z. Emmerson që përfaqëson z. Veseli ka pyetjet për
12 ju.

13 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]

15 PY. Mirëmëngjes.

16 PË. Mirëmëngjes.

17 PY. Shumë pak pyetje kam. Do t'ju bëj një a dy pyetje lidhur
18 me rolin tuaj në hartimin e dokumenteve të ndryshme bashkë me
19 z. Sadik Halitjaha.

20 Pikësëpari, besoj se e keni thënë një herë, kur ju
21 intervistoi ZPS-ja keni thënë se keni pasur bashkëpunim për
22 hartimin e dokumentave ligjore. Pra, bashkëpunim mes jush the
23 z. Sadik Halitjaha.

24 PË. Po, i nderuar.

25 PY. Dhe përgjithësisht këto kanë qenë dokumente që do të

1 shërbimin si bazë për rregullat dhe rregulloret të një lloji
2 apo të një lloji tjetër. Kështu?

3 PË. Një rregullore ka qenë, z. Avokat, një rregullore e
4 vetme për mirësjelljen. Ajo ka qenë, s'ka pas tjetër. S'kemi
5 pas kohë të tjera me -- me hartu me përpunu. Kemi qenë në
6 gjendje lufte. Ato kanë qenë mbase të domosdoshme, elementare.
7 Ka pas ato pale çfarë të bëjnë me ato rregulloret se s'kemi
8 pas as aeroplan, as s'kemi pas tenka, as kemi pas -- kemi qenë
9 ushtarë të thjeshtë me një automat në krah, dikund ndonjë zoll
10 e qeto janë kon armët tona.

11 PY. E kuptoj këtë, e kuptoj. Por z. Sadik Halitjaha ka pasur
12 përvojë ushtarake apo jo?

13 PË. Jo, ka pas prirje ushtarake, jo përvojë. Prirje ka pas se
14 s'ka pas të kryme kurrgjë ushtarake. Sa di unë, s'ka pas.

15 PY. Po a s'ka studiuar ai rregulloret ushtarake të ushtrive
16 të rregullta në mënyrë që të përgatisnit një rregullore për të
17 ardhmen së bashku? E kam kuptuar unë saktë?

18 PË. Po këto rregullore nuk kanë qenë për të ardhmen, këto
19 kanë qenë *ad hoc* aty për aty. Se për të ardhmen ato na kemi
20 tash kemi ligje kemi krejt ato që i miraton një qeveri, i
21 miraton parlamenti. Ato s'kanë vlej, ato kanë vlej aty për
22 aty sa për mos me pas hiç ma mirë ka qenë një rregullore - mos
23 të them e dobët, e keqe sesa hiç. Kështu që q'ashtu na e ka
24 marrë mendja edhe ashtu e kemi ba në bazë të përvojave që kemi
25 pas.

1 PY. Thatë që keni pasur vetëm -- thatë që keni pas një

2 rregullore që e mbanit në sirtarin tuaj, kështu?

3 PË. Ashtu ka qenë.

4 PY. Përafërsisht të kujtohet sa faqe ishte ky dokument?

5 PË. Tybe s'po di, kam harru tash se s'e kam pa këtë 25 vjet,

6 30 -- i bjen ma shumë. Përafërsisht ka qenë broshurë e vogël.

7 PY. Pra, me pak faqe apo ka qenë ndonjë si libërth?

8 PË. Ka qenë një kopertinat e dobta po pak faqe. S'ka pas,

9 s'ka qenë libër, i vogël ka qenë, broshurë.

10 PY. Ky është dokument i përgatitur në zonën e Pashtrikut apo

11 është një dokument që ka qarkulluar gjithandej?

12 PË. Besoj vetëm për zonën e Pashtrikut. Vetëm për zonën e

13 Pashtrikut

14 PY. Ke pasur përfshirje, pra ke luajtur ndonjë rol në

15 hartimin e kësaj rregulloreje?

16 PË. Pak a shumë. Pak a shumë, po.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pikësëpari, a mund t'i kërkoj

18 Sekretarisë që të shfaqë në ekran materialin me numër P716 që

19 besoj se ta kanë treguar gjatë seancës përgatitore.

20 PY. A kam të drejtë unë të them që për herë të parë këtë

21 dokument e keni parë gjatë seancës përgatitore?

22 PË. Shumë e vërtetë.

23 PY. Shohim datën këtu që është 8 shkurt 1999, edhe ka titull

24 "Informatë në njësitë e UÇK-së mbi rastet e jashtëzakonshme".

25 Nëse shkojmë poshtë në të djathtë shohim që është nënshkruar

1 nga ndihmëskomandanti për moral Sadik Halitjaha. E shihni?

2 PË. Po. Po.

3 PY. Të shohim përmbajtjen. Lexojmë pikën 1, ka lidhje me
4 plagosjen e ushtarit të Brigadës 122, Bashkrim Kryeziu, nga
5 një bashkëluftëtarët e tij në zonën e Pashtrikut. Fjala e
6 fundit -- në fjalinë e fundit Sadik Halitjaha thotë që përveç
7 lëndimit fizik që ka -- nga i cili ka vuajtur personi "do t'i
8 përgjigjet gjykatës së shkallës së dytë".

9 Edhe e njëjta gjë thuhet edhe në pikën 2; me fjalë të
10 tjera që çështja është në pritje të përcaktimit të
11 përgjegjësisë pranë të njëjtës gjykatë.

12 Të fokusohemi tek këto të dyja. Në rastin e ngjarjes së
13 dytë, ushtari thuhet "është duke vuajtur dënimin dhe pritët
14 përcaktimi i përgjegjësisë pranë të njëjtës gjykatë". Pra
15 është gjykata e shkallës së dytë.

16 Pikësëpari, si e kuptoni ju termin "Gjykatë e shkallës së
17 dytë". Çfarë është kjo sipas jush. Po flas në përgjithësi
18 tani.

19 PË. A po më pyet në rastet civile çka është gjykata e
20 shkallës së dytë apo në luftë? S'po e kuptoj. Në qoftë se në
21 civile e di mirë shumë edhe ti edhe unë se unë jam i q'asaj
22 dege, dhe e di çka është gjykata e shkallës së parë, gjykata e
23 shkallës dytë, shkallës së tretë. A në luftë unë s'di që ka
24 pas kund gjykatë por megjithatë unë në këtë kohë unë s'kam
25 qenë fare. Ça ka aludu Sadiku këtu unë nuk e di. Sigurisht ai

1 duhet me e dit.

2 S'ka pas as ushtri të organizume mirë në këtë kohë kur e
3 ka bo këtë në mujin e dytë, unë në mujin e tretë jam kyç në
4 zonë. S'kam qenë fare. Çfarë ka dashtë me thënë me këtë nuk
5 di. Po këto kanë mujt ma tepër me qenë lloj propagande,
6 fiksimi të ushtarëve që të mos mendohet diçka e ngjajshme. Ma
7 merr mendja, mendimi im është prapë. Nuk mund të them kurrgjë
8 me vërtetësi. Këtë dokument e kam pa para një jave kur ma ka
9 prezantu Prokurori, përndryshe sot po çuditna me këtë.

10 PË. Sidoqoftë në asnjë moment siç na thatë nuk ka ekzistuar
11 asnjë gjykatë e jo më pastaj gjykatë e shkallës së dytë. A
12 është e saktë me aq sa keni ju dijeni?

13 PË. Por jo mor s'ka pas kurrfarë gjykate. Këto janë kon ma
14 tepër, e thashë edhe ma herët, dëshira, dëshira që të jetë një
15 organizim i tillë i pasqyru edhe në formularë edhe në
16 transkripte. Po tjetër është -- prapë po e them, tjerët është
17 dëshira, tjetër është mundësia. Mundësitë kanë qenë minimale
18 që ne të organizojmë një Gjykatë sikur që përshkruhet edhe
19 nëpër dokumente. Dëshirat e kemi pas të gjithë. Ambiciet i
20 kemi pas, por mundësi s'i kemi pas asnjë.

21 Na edhe dëshirën e kemi pas dhe kemi hi në luftë me luftu
22 me një superfuqi ballkanike edhe dihet qysh jemi nda. Po ajo
23 ka qenë dëshirë. Edhe me përkrahjen e NATO-s e kemi bo luftën.
24 Sikur mos kish qenë NATO bon vaki ende ishim qenë nëpër male
25 na. Se kemi pas punë me një armik të veçantë, me një armik të

1 paskrupullt, me një armik që me qindra vjet na ka sundu dhe ka
2 dashtë me na qit fare krejt ne na ka përzënë, një milion
3 banorë janë përzënë nga vendi. Kosovë një milion e gjys e ka
4 pas, një milion janë përzënë me dhunë. Ju kanë shky dokumentat
5 e identifikimit, krejt ju kanë marrë, në mënyrë që të mos
6 mundem me u kthy. Që kjo është gjenocid. Unë nuk di qysh
7 ndryshe gjenocidi këtu don me shfaros një popull.

8 PY. Nuk desha t'ju ndërprisja --

9 PË. Okej.

10 PY. -- por do të flas për ato që keni vrojtuar ju dhe ju
11 thoni se kjo është një lloj propagande nga ana e z. Halitjaha.
12 Sipas jush në këto dokumente mund të ndodhte ndonjëherë që në
13 këto dokumente përmendeshin institucione që në të vërtetë nuk
14 ekzistonin. Mos ishte një tipar i përbashkët i shumë
15 dokumenteve kjo?

16 PË. Nuk mund t'ju them asgjë për këtë. S'di, çka s'di nuk
17 mund të flas. Nuk di.

18 PY. A është hera e parë gjatë gjithë jetës që keni qenë në
19 Kosovë është kjo hera e parë që shihni një dokument të UÇK-së
20 që i referohet një institucioni që në thelb është propagandë?
21 Domethënë a të ka ndodhur ndonjëherë që të keni parë dokumente
22 të cilët përdorëshin si formë propagande?

23 PË. Po q'ky po, por edhe të tjera kam dëgju se me pa s'kam
24 pa. A kam dëgju që ka. Çdo luftë ka propagandën. Luftën e mban
25 propaganda. Na e dimë shumë mirë. Edhe ato që s'janë, në luftë

1 zmadhohen, përforcohen me bindje të qytetarëve se na jemi të
2 fuqishëm na kemi këto, na kemi këto, në fakt ne e kemi ditë
3 fuqinë tonë. Se propaganda e mban luftën.
4 PY. Nëse është e mundur dua t'ju pyes për një dokument
5 tjetër. Kur dhatë dëshmi për herë të parë, -- më falni, z.
6 Halitjaha kur ka dëshmuar për herë të parë ka thënë që e ka
7 hartuar këtë dokument me ndihmën tuaj. Nuk mendoj se ky
8 dokument ju është treguar gjatë seancës përgatitore. Më pas ai
9 reflektoi për dëshminë e tij dhe doli në përfundim që në fakt
10 me ndihmën tënde kishte hartuar një dokument tjetër. Pra, kemi
11 dy përgjigje nga z. Halitjaha lidhur me dokumentin në fjalë.
12 Dhe unë do t'ua tregoj këtë.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Materiali në gjuhën shqipe mban
14 numrin U009-1596 deri në 1662. Dhe do lutesha që të shfaqej
15 përbri përkthimi në gjuhën angleze, që mban numrin 1596 deri
16 në 1641-ET.

17 PY. Shohim ballinën edhe shihni edhe sesi është titulli që
18 thotë: "Rregullore e Disiplinës në Ushtrinë Çlirimtare të
19 Kosovës, Prishtinë, 1998".

20 Ju keni qenë pjesë e UÇK-së dhe këshilltar juridik për
21 UÇK-në në 1999, 1998, kështu?

22 PË. 1998 në batalionin e 1-rë të Budakovës, prej qershorit,
23 26 qershorit 1998.

24 PY. Po. Së pari dua të lexojmë nja dy paragrafë të këtij
25 dokumenti bashkë.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sekretar i Gjykatës, do ju
2 referohem numrit të paragrafëve dhe jo faqeve. Shohim
3 fillimisht paragrafin 2. Në anglisht është faqja e parë, dhe
4 kalon pastaj tek faqja tjetër. Pra, do të shikojmë paragrafin
5 2 pikën a dhe b. Më duket se shqipja i ka të gjithë në një
6 faqe.

7 PY. Këtu përkufizohet termi ushtarak, bëhet përkufizimi i
8 termit ushtarak që shërben në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës ose kryen detyrimet e përcaktuara me Rregulloren e
10 UÇK-së. Te pika 2 pastaj thotë:

11 "Ushtarakë të UÇK-së janë:

12 "a. Oficerët e shërbimit aktiv të UÇK-së e të Forcave
13 Territoriale të UÇK-së, të rendit publik të themeluar nga UÇK-
14 ja dhe të Shërbimit Informativ të UÇK-së ..."

15 Ju lutem të kalojmë tek faqja tjetër.

16 "... si dhe oficerët rezervë kur janë në shërbim direkt
17 të UÇK-së."

18 b.:

19 "Nënoficerët e shërbimit të detyrueshëm aktivë dhe në
20 rezervë kur janë duke kryer shërbimin në UÇK.

21 Tek c-ja thuhet:

22 "Ushtarët e shërbimit të detyrueshëm dhe në rezervë kur
23 janë duke kryer shërbimin ushtarak."

24 E vajon -- e vijon, më falni.

25 Këto kategori a kishin ndonjë farë kuptimi në vitin 1998

1 apo 1999, a kishin ndonjë farë kuptimi këto kategori -- a
2 bënin dallim këto kategori brenda UÇK-së? Kishin ndonjë
3 kuptimin?

4 PË. Jo.

5 PY. Dhe na thatë që s'ka pasur as shërbim të detyrueshëm,
6 kështu?

7 PË. Jo, s'ka pas aspak. Krejt ka qenë vullnetare.

8 PY. As forcat territoriale të UÇK-së apo jo?

9 PË. Po jo, krejt çka ka ekzistuar ka ekzistuar q'aty mrena
10 batalionit, mrena brigadës, mrena sektorëve të tjerë më të
11 ultë. Kjo në përgjithësi e ka përshkruar qysh është dashtë me
12 qenë struktura.

13 PY. Në një ushtri tradicionale?

14 PË. Q'ashtu bravo.

15 PY. Shohim, për shembull, paragrafin 3, 3(1):

16 "UÇK-ja ka strukturë hierarkike."

17 E shihni? "UÇK-ja ka ndërtim hierarkik".

18 PË. Po.

19 PY. Do të bëj këtë pyetje: Kur mbërrite atje në mes të 1998,
20 sipas jush kishte UÇK-ja strukturë hierarkike apo ishte një
21 struktura horizontale?

22 PË. S'ka pas në 1998 strukturë, nuk ka pas. Vetëm në nivel të
23 batalionit na kemi pas, në nivel të batalionit kanë qenë
24 skuadra, togu, kompania dhe brigada.

25 PY. Shohim paragrafin 13 që është pjesë e kreut III, ku

1 flitet për shpërblimet e ndryshe brenda -- e shihni kreun III.

2 Do të dali për një çast tek shqipja.

3 E shihni titullin, ë? Flitet për shpërblimet, për gradat
4 e ndryshme që mund t'u jepen ushtarëve në këtë hierarki
5 hipotetike.

6 Dhe lexojmë paragrafin 15 dhe 16.

7 Siç mund ta shihni në paragraf 15, thuhet për ushtarët e
8 oficerët e shërbimit të detyrueshëm i jepen këto shpërblime.
9 Që nga fillon nga falënderimet mund t'i bëhet një fotografi
10 personale personit para flamurit ushtarak dhe shkon deri tek
11 dekorimet me urdhra e medalje të ndryshme, propozim.

12 Ka pasur urdhra e medalje -- janë bërë medalje në UÇK?
13 Bëheshin medalje në UÇK-së për t'i shpërblyer ushtarët nën-
14 oficerët?

15 PË. Por jo mor, na bukë s'kemi pas me hongër, ça medalje. Ka
16 pas shpërblime -- s'ka pas kurrëgjë. Tash prapë po them, kjo
17 është një shprehje e një dëshire që të jetë kështu. Por kjo ka
18 qenë e pamundur që të arrihet në rrethanat tona specifike që
19 kemi pas. Kanë rrethanat të jashtëzakonshme.

20 PY. Në paragrafin 16. Për oficerët me grada, po ashtu ka
21 nivele të ndryshme apo shpërblime të ndryshme që mund të
22 jepeshin nga komandanti i skuadrës, i batalionit, i togës. Po
23 kjo, a është një -- a ka qenë vërtetë kështu situata në 1998?
24 Kështu ka qenë e organizuar?

25 PË. Në batalionin tonë, po, kështu ka qenë. Prej skuadrës,

1 togut, kompanisë, dhe deri te brigada. Kështu ka qenë. Flas
2 për batalionin e Budakovës.

3 PY. Keni pas komandant toge mbi veten në batalionin Budakovë?

4 PË. Si mendoni mbi vete?

5 PY. Se po të shikojmë gradat domethënë, gradat a janë një
6 përshkrim real i situatës në Budakovë dhe në Kosovë në 1998?

7 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, është dhënë përgjigja
8 dhe ka -- është bërë pyetja dhe ka marrë përgjigje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

10 Vazhdoni, Dëshmitar.

11 DËSHMITARI: Nuk ka pas grada atëherë. S'ka pas kurrfarë
12 grade vetëm kanë qenë prej skuadrës, togu, kompania dhe
13 brigada. Kanë qenë njerëz të caktum ashtu, pa grada. Kurrkush
14 s'ka pas gradë. Kurrkush s'ka pas gradë.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shohim pikën 6, te paragrafi 16.
16 Ka një listë shpërblimesh që mund të jetë [E pakuptueshme] nga
17 -- ëëë -- bëhet fjalë për komandantin e korpusit këtu,
18 divizioni, MKA-ja, aviacioni, këtu e ka për marinën fjalën?

19 PË. Jo, qysh kjo s'është -- s'besoj që është kjo rregullore
20 që është e jona.

21 PY. Do bëj një pyetje: Sa anije edhe aeroplanë kishte UÇK-ja
22 në vitin 1999?

23 PË. 500.

24 PY. Luftaniye sa kishit?

25 PË. 500. Mos boni shaka, ju lutem. Ju lutem, a e njifni

1 Kosovën, a e dini ku gjindet Kosova? E njihni sa sipërfaqe ka?
2 A mundet një aeroplan me ateru nëpër territorin e Kosovës? Mos
3 të bëjmë shaka se jemi njerëz seriozë dhe të përgjigjemi
4 seriozë. S'janë këto pyetje. Pyetje janë të paqena, pyetje të
5 ndaluara sa di une. Ju lutem, z. Avokat, kini kujdes.

6 PY. Po, po, por këto -- po ky ishte dhe qëllimi i pyetjes
7 sime, pra këtë po përpiqem të them edhe unë që vetë te ky
8 dokument në tërësinë e tij nuk është dokument real.

9 PË. Jo, të lutem, të lutem. S'është ky dokument real.

10 PY. A mund të na sqaroni nëse përgjigja që ka dhënë Sadik
11 Halitjaha fillimisht që këtë dokument e ka hartuar me ndihmën
12 tuaj apo do ua bëj pyetjen kështu: A keni pasur ju përfshirje
13 në hartimin e këtij dokumenti?

14 PË. Jo, ky dokument s'është i joni. Ky është i Shqipërisë. Ne
15 s'kemi flotë, na s'kemi aviacion. Edhe e pashë edhe në fillim
16 ishte për çështje të rezervave, detyrimin ushtarak. S'kemi
17 pasë ne këto, s'i kemi pas kurrë. Unë e thashë, e disata herë
18 është që e përmendi, ushtri vullnetare, ushtria vullnetare.
19 Nuk mundet me e obligu. Grada s'kemi pas. Nuk mund të flitet
20 për to. Diçka po aludohet, çka po mendoni, nuk e di. Unë
21 thashë, ju bona edhe një pyetje të thjeshtë, a e njihni
22 Kosovën ku është edhe çfarë territori ka.

23 PY. Po. Pyetja ime është e thjeshtë: A mos ka qenë thjesht
24 kjo një aspiratë, një dokument ambicion, po e themi, për të
25 cilin keni dhënë ndihmën tuaj për ta hartuar apo nuk keni

Dëshmitari: Nuredin Abazi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 52

1 kurrfarë lidhje në hartimin e këtij dokumenti. E keni parë

2 ndonjëherë më përpara këtë dokument?

3 PË. Jo. Q'ky s'kemi lidhje me këtë hiç.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

7 z. Emmerson.

8 Gjykatë Mettraux ka një pyetje për z. Pace.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] z. Pace, thjesht do të
10 doja të përsërisja dhe kërkesën që i bëra dje Prokurorit, që
11 të verifikoni nëse keni një version më pak të redaktuar ose të
12 paredaktuar të provës materiale P987. Ju lutem, ma jepni
13 përgjigjen brenda ditës së sotme.

14 Z. PACE: [Përkthim] Patjetër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,
16 do të keni pyetje?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Alagendra, unë e di që keni pushime [Sipas përkthimit] po ne
20 do të bëjmë pushimin e paradites tani në mënyrë që të mos ju
21 ndërpresim.

22 Dëshmitar, tani do të bëjmë gjysmë ore pushim. Mund të
23 dilni nga salla me Asistenten e sallës së gjyqit. Mos flisni
24 me askënd për dëshminë tuaj jashtë kësaj salle.

25 DËSHMITARI: S'kam nevojë me fol.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Rifillojmë në orën 11.30.

4 --- Pauza fillon në orën 10.59

5 --- Seanca rifillon në orën 11.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

7 silleni përsëri dëshmitarin në sallë.

8 Po, James, z. Pace.

9 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

10 Sa i takon pyetjes që bëri Gjykatësi Mettraux, më thanë
11 që versioni i paredaktuar i provës materiale P987 mund të
12 gjendet në dokumentin me SPOE00248598 deri në 00248641, faqet
13 4 deri në 34. Ky material është nxjerrë sipas rregullës
14 102(1)(b).

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit shumë.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

18 znj. Alagendra, që është përfaqësuesja e z. Krasniqi, do t'ju
19 bëj pyetje ju tani.

20 Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra:

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

22 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar. Unë jam znj. Alagendra edhe jam

23 Mbrojtësja ligjore e z. Krasniqi. Nuk është se kam shumë

24 pyetje për ju.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Së pari, të shohim pak provën

- 1 materiale P01136 Pjesa 1, faqet nga 27 deri në 28. Do i
2 kërkoja sekretarit ta paraqesë në ekran këtë dokument.
3 Përkthimi në gjuhën shqipe është në faqen 33 deri në 34.
4 PY. Kjo është pjesë e intervistës që i keni dhënë
5 Prokurorisë, Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje që kanë të
6 bëjnë me këtë pjesë të intervistës tuaj. Ju thoni që jeni
7 jurist me profesion, apo jo, Dëshmitar?
8 PË. Po e kam deklaruar edhe në fillim.
9 PY. Po. Po ashtu ju thoni që jeni ekspert dhe keni këshilluar
10 udhëtarët lidhur me mënyrën sesi ata duhet të trajtonin
11 civilët qofshin ata burra, gra, pleq, plaka, civilë, fëmijë të
12 moshuar, kështu?
13 PË. Ashtu është.
14 PY. Mesazhi juaj ka qenë i qartë, apo jo? ju i keni thënë
15 ushtarëve që të mos keqtrajtonin askënd sepse ju e dini që
16 ndonjëherë civilët mund të bënin ndonjë gabim ose mund të
17 thonin diçka që mund të keqinterpretohet, apo jo, Dëshmitar?
18 PË. Shumë e vërtetë.
19 PY. Dhe këshilla juaj ishte që të mos i keqkuptonit njerëzit
20 sepse ata ishin në shtëpitë e tyre, a është kështu, Dëshmitar?
21 PË. Po.
22 PY. Ju këtë e keni thënë sepse ju ishit ekspert, ishit jurist
23 dhe se kjo ishte pjesë e kërkimeve, e hulumtimeve tuaja, apo
24 jo, Dëshmitar?
25 PË. Normalisht.

1 PY. Ju e dinit që do vinte një ditë pas lufte që personat e
2 implikuar do të mbanin përgjegjësi ose personat të cilat
3 kishin ushtruar aktivitete që ishin pranë aktiviteteve të
4 dyshimta, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Patjetër. Çdo fillim e ka dhe mbarimin.

6 PY. Ju ishit në dijeni se të gjithë ata që mund të kishin
7 bërë diçka do të mbanin përgjegjësi për veprimet e tyre, apo
8 jo, Dëshmitar?

9 PË. Po ashtu është edhe praktika.

10 PY. Ju po përpiqeshit që të siguroheshit që ushtarët
11 silleshin si ushtarë dhe që silleshin me humanitet me
12 njërzillëk ndaj civilëve, apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Detyra ime ka qenë q'ajo.

14 PY. Këto kanë qenë përpjekjet tuaja që ata të respektonin
15 ligjin sepse një ditë do të jepnin llogari në qoftë se nuk e
16 bënë diçka të tillë, apo jo?

17 PË. Ashtu.

18 PY. Dje na dhatë dëshmi që detyrat tuaja si këshilltar
19 juridik kanë filluar në prill të 1999 të cilat nuk kanë qenë
20 të ndryshme nga detyrat tuaja si këshilltar juridik përpara
21 përfundimit të shtatorit të 1998. A ju kujtohet ta keni thënë
22 dje, Dëshmitar?

23 PË. Po, të njëjtat kanë qenë.

24 PY. Pra, është e drejtë, apo jo, që UÇK-ja në zonën e
25 Pashtrikut donte që ushtarët të silleshin sipas ligjit dhe të

1 silleshin në mënyrë të denjë me civilët, në veçanti me gratë,
2 me fëmijët dhe personat që ishin të sëmurë, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Po ashtu të edukuar mirë sipas mundësive të luftës, sipas
4 mundësive të rrethanave të luftës. S'e di sa po kuptohemi.

5 PY. Po. Po. Po ishte e vështirë sepse ju kishit të bënit me
6 njerëz që nuk ishin të edukuar që kishin marrë armët, kështu
7 që ju duhet t'i përgatisnit ata që të përgatiteshin ose t'i
8 informonit ata për gjëra që mbase ata nuk i dinin, apo jo?

9 PË. Nuk mund të them që s'ishin të edukuar, por nuk kishin
10 njohuri për ato.

11 PY. E drejtë. Gjithashtu keni dëshmuar se nuk keni këshilluar
12 komandant, nuk është se keni dhënë këshilla për komandantët
13 por vetëm për ushtarët, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Saktë.

15 PY. Në përgjigje të pyetjes së z. Misetić dje, ju thatë që
16 zakonisht i raportonit Tahir Sinanit që ishte komandanti i
17 shtabit të zonës. A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Tahir Sinani dhe Sadik Halitjaha e dinit çfarë roli
21 kishit ju dhe çfarë detyrash kryenit ju, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Po Tahir Sinani më ka emnu në atë rol, në atë pozitë,
23 komandanti Tahir Sinani.

24 PY. Po. Dhe ata nuk janë përpjekur t'ju minojnë juve, apo jo?

25 PË. Hajgare është kjo?

1 PY. T'ju dëmtojnë?

2 PË. Është hajgare kjo? Qysh një komandant ta minojë stafin e
3 vet? A është në rregull kjo sipas juve?

4 PY. Pra, e kam fjalën për këshillat që i keni dhënë
5 ushtarëve, nuk është se janë munduar të të minojnë sa i takon
6 dhënies së këshillave për ushtarët? Ose e thënë me fjalë të
7 tjera, ata nuk është se të kanë thënë ty që thuaj ushtarëve që
8 të bisedojnë me civilët, t'i kërcënojnë ata, të përfitojnë
9 prej tyre e kështu? Nuk është se t'i ka thënë këto gjëra, apo
10 jo, Dëshmitar?

11 PË. Fjala "minim" ishte shumë e vështirë, shumë e keqe qysh e
12 thatë ju. Ndoshta përkthimi është i ardhur keq. Minim është
13 diçka e keqe. Askush nuk ka dëshirë as qëllim me minu stafin e
14 vet. Unë kam qenë në stafi i zonës. I emnun përmes tyre,
15 përmes komandantit. Edhe secili komandant ka qejf që puna me i
16 ec mbarë, secili udhëheqës puna me i hec mbarë mos me pas
17 probleme. Si të të minon atëherë me minu stafin e vet. Çka i
18 thotë kjo? Çka bie kjo? Veç se është në kundërshtim me
19 vetveten.

20 PY. E kuptoj. Dhe ata donin që ju t'i tregonit ushtarëve që
21 duhet të silleshin siç duhej të silleshin në mënyrë të denjë,
22 apo jo?

23 PË. Normale.

24 PY. Roli juaaj si këshilltar juridik nuk është se ishte në një
25 post ose pozitë e rregullt në çdo brigadë, apo jo, Dëshmitar,

1 me aq sa dini juve, kuptohet, nuk është se e kishte çdo

2 brigadë këtë si rol në organigram?

3 PË. Jo, s'kanë mujt. S'kanë mujt me pas.

4 PY. As nuk ishte ndonjë post i rregullt në çdo zonë, apo jo?

5 PË. Për zona tjera nuk di. Unë flas veç për zonën unë ku kam
6 qenë.

7 PY. Do të kaloj në një temë tjetër tani. Dëshmitar, ju keni
8 qenë i pozicionuar në Kosterc në prill dhe në maj të 1999. A
9 është e saktë kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Fshati i Kostercit është pjesë e komunës së Suharekës?

12 PË. Po.

13 PY. Ka pasur një periudhë ku qyteti ka qenë i kontrolluar nga
14 forcat serbe, apo jo, në këtë kohë?

15 PË. Gjithmonë ka qenë i kontrolluar qyteti nga forcat serbe.
16 Gjithnjë, jo një periudhë. Gjithnjë.

17 PY. Në rregull. Dhe shqiptarët që kanë jetuar aty dhe në
18 fshatra të tjera në afërsi të bazave serbe i lanë shtëpitë e
19 tyre dhe shkuan nëpër male për t'u strehuar, a është e saktë
20 kjo, Dëshmitar?

21 PË. Shumë e saktë. Disa kanë shku në për male. Disa ma vonë
22 kur është intensifikue presioni dhe bombardimet e NATO-s janë
23 përzënë të gjithë me dhunë jashtë shtetit, disa në Shqipëri,
24 disa në Maqedoni, një pjesë e vogël ka Mali i Zi.

25 PY. UÇK-ja po përpiquej që t'i mbante këto fshatra sepse

1 kishin frikë se forcat serbe mund të hynin dhe të masakronin
2 popullatën civile atje, apo jo?

3 PË. E vërtetë është.

4 PY. Në atë kohë, afërisht, e dini ju sesa refugjatë kanë qenë
5 të strehuar në fshatrat përreth Kostercit?

6 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtoj sa i
7 takon relevancës. Sepse mendoj se sa i takon kësaj teme është
8 e rëndësishme që Mbrojtja të mund të shpjegojë se cila është
9 relevanca.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ka të
11 drejtë Prokurori. Ju lutem thoni se cila është lidhja, cila
12 është relevanca.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 dëshmitari ka dëshmuar se thujse një milion shtetas ose
15 banorë janë dëbuar. Thjesht unë dua të di sesa ka qenë
16 vlerësimi i popullatës refugjate në ato fshatra.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë
18 arsye, pse ju duhet ky informacion?

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për të treguar se cila ka qenë
20 situata në atë kohë atje. E sepse ai ka operuar në ato fshatra
21 dhe besoj se është personi i duhur për t'ju përgjigjur këtyre
22 pyetjeve.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë.
24 Vazhdoni. Po mundohuni që t'i bëni relevante për temat tona të
25 diskutimit.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. A mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar? Domethënë, në
3 atë kohë, afërsisht, sa ka qenë numrin i refugjatëve që kanë
4 qenë të strehuar në fshatrat përreth Kostercit?

5 PË. Numri ka qenë me mijëra, po unë thashë se janë dëbuar
6 rreth 1 milion nga të gjithë Kosova, jo vetëm nga zona jonë,
7 nga e gjithë Kosova. Të lutem, s'di sa e keni kuptu. Se Kosova
8 ka pas 1 milion e gjysë, s'i ka pas bile. Atëhere një milion
9 kanë qenë dëbuar jashtë, një pjesë në Shqipëri thashë, një
10 pjesë në Maqedoni, një pjesë e vogël në Mal të Zi ku kanë pas
11 farefisllëk naj kund, të njoftun të vetë po mendoj. Edhe kjo
12 ka qenë shumë e vërtetë, shumë relevante. Flas për tërë
13 Kosovën, jo vetëm për zonën e Pashtrikut.

14 PY. Po numri i refugjatëve që kanë qenë të strehuar në
15 fshatrat përreth maleve të Berishës sa kanë qenë afërsisht ata
16 numër?

17 PË. Po na nuk i kemi ndjena, kemi folim vetëm në perceptime.
18 Kanë qenë me mijëra, me mijëra kanë qenë.

19 PY. Dëshmitar, ju na shpjeguat që LDK-ja filloj si një
20 lëvizje popullore dhe u përçafua nga çdo kosovar me kalimin e
21 kohës, a është e saktë kjo, apo jo?

22 PË. Po, e saktë është kjo. Para luftës në vetët 1990 kur ka
23 dalë LDK-ja të gjithë popullata kanë qenë të kyçur në LDK.

24 Duke menduar se do të arrihet diçka përmes paqes, përmes
25 bisedimeve, përmes kësaj, mendoj, kësaj iniciative, por kur u

1 pa që kjo nuk do të ketë sukses dhe nuk pat sukses dhjetë
2 vitet në vazhdim, atëherë e domosdoshme ishte që të lind një
3 lëvizje tjetër, e cila ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës.
4 Pasi që nuk dha fryte teoria e Ibrahim Rugovës.

5 PY. Megjithatë, është e saktë, apo jo, që shumë anëtarë të
6 LDK-së u bënë pjesëtarë të UÇK-së, u kyçën në UÇK, apo jo,
7 Dëshmitar?

8 PË. Patjetër. I tërë populli ka qenë në UÇK. S'ka pas parti
9 në UÇK. Në UÇK kanë hi të gjithë. Kur ka fillu lufta partitë
10 janë shu. S'ka pas politikë ma.

11 PY. Dhe shumë prej tyre i kanë shërby UÇK-së në mënyrë të
12 ndershme gjatë gjithë kohës dhe janë persona të respektuar,
13 janë respektuar për kontributin e dhënë në UÇK, apo jo,
14 Dëshmitar?

15 PË. Patjetër.

16 PY. UÇK-ja ka buruar dhe që është mbështetur nga fshatrat
17 lokalë, apo jo, është formuar dhe është mbështetur nga
18 fshatrat lokalë?

19 PË. Nga populli. Nga populli. Dhe nga fshatrat edhe nga
20 qytetet është mbështetur. Patjetër që qytetet i ka pas në
21 menaxhim armiku se s'kemi mujt na me hy në qytete se atëherë
22 bëjshin masakra. Në qoftë se një ushtar i Serbisë vritet ose
23 një polic, atëherë ata masakronin një popullatë të tërë. Është
24 edhe ajo thënia e luftës në Bosnje 1:100, në qoftë se një
25 ushtar ose polic i Serbisë vritet, njëqind tjerë kanë me pësu,

- 1 pa marrë parasysh a janë fëmijë, a pleq, a gra, a të
2 pafuqishëm. Vetëm në fshatin tim janë vra, janë masakru mbi 30
3 veta e nuk shkruhet askund. Është masakrue burri me gjithë
4 gruan të palëvizshëm në krevat janë djeg për së gjalli. Këto
5 janë shumë të vërteta nuk kemi çka me laboru.
- 6 PY. Pas masakrës së Jasharëve dhe masakrave të tjera ka pasur
7 besoj një frikë të vazhdueshme ndërmjet popullatës kosovare që
8 forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe do të futeshin në
9 fshatrat e tyre dhe do masakronin familjet e tyre? Për këtë e
10 kishit fjalën në përshkrimin që sapo dhatë, apo jo, Dëshmitar?
- 11 PË. S'e kuptova. Dhe një herë?
- 12 PY. Ajo çfarë po them është që kishte një frikë të
13 vazhdueshme ndërmjet njerëzve që forcat ushtarake dhe
14 paramilitare serbe do të futeshin në fshatra do masakronin dhe
15 familje e tyre siç kishin bërë në ca raste tjera, apo jo?
- 16 PË. Patjetër. Askush s'ka mujt me i ndalë ata
- 17 PY. Në përvojën tuaj, a ka ndodhur që fshatrat të shpërndanin
18 thashetheme mbështetur në dyshimet e disa njerëzve se ata i
19 jepnin informacion forcave serbe?
- 20 PË. Po thashetheme ka pas në luftë gjithçka, po s'kanë qenë
21 relevante.
- 22 PY. Pajtoheni me mua, apo jo, që rreziku ndaj civilëve ishte
23 edhe më i madh në fshatrat ku dihej që kishte bazë UÇK-je ose
24 ku funksiononte, operonte UÇK-ja, apo jo?
- 25 PË. Kishte rrezik shumë më të madh, po ne jemi mundu me i

1 mbrojt ata me të gjitha forcat që kemi pasur derisa jemi është
2 thye rezistenca me shumë mund. Ka zgjatë ndoshta rezistenca ka
3 zgjatë muj derisa kanë hy me një territor të UÇK-së pi
4 rezistencës tonë. Po, megjithatë, forcat e mëdha kur kanë pa
5 që është e rrezikshme, kur kanë kalue ditë të tëra mes sulmit
6 dhe e kanë thy pikën. Kështu që e tërë Kosova ka qenë në këtë
7 gjendje.

8 PY. Shumë faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera
9 për juve.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
11 znj. Alagendra.

12 Z. Pace, keni pyetje plotësuese?

13 Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, shkurtimisht
14 kam disa pyetje procesverbal dëshmitarin.

15 Pyetje vijuese nga z. Pace:

16 Z. PACE: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, më herët sot kur po flisnit për veprimet e
18 Agim dhe Naim Kadollit [Sipas përkthimit] ne dëgjua si më
19 poshtë. Dhe, për procesverbal, po lexoj nga faqja 30 e
20 transkriptit të ditës së sotme, rreshti 15 deri në 17.

21 Dëshmitar, pyetja ishte që:

22 "Ata ai morën gratë?"

23 Dhe kur them për "ata" e kam fjalën për Agim Zybën dhe
24 Naim Kadollin.

25 Dhe përgjigja juaj ishte kjo:

1 "Nuk e di. Unë propozova që ato të liroheshin. Por nuk e
2 di se çfarë ndodhi më pas".

3 Dëshmitar, a ju kujtohet që keni deklaruar në intervistën
4 me ZPS-në në vitin 2020 se pasi Agim Zyba dhe Naim Kadolli
5 kishin transferuar Latifën dhe Rushe Kolollin, ata ju kanë
6 thënë juve që e kishin çuar ata në brigadë? A ju kujtohet ta
7 keni thënë këtë, po apo jo?

8 PË. Jo. Ku i kanë çu nuk e di unë. As kam pas informacion.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në këtë rast do i kërkoja Sekretarit
10 të Seancës që të paraqesë provën materiale P1136.1-ET, përbri
11 provës materiale P1136.3. Në versionin në anglisht do të lexoj
12 nga faqja 18, rreshti 17 deri në faqen 19, rreshti 6. Kjo
13 pjesë përkon me përkthimin në shqip nga faqja 22, rreshti 17,
14 në faqen 23, rreshti 16.

15 PY. Sikurse mund ta shikoni nga dokumenti që keni përpara,
16 Dëshmitar, kjo është pjesë e marrë nga intervista me ZPS-në në
17 vitin 2020. Do t'ju lexoj një pjesë të intervistës së dhënë
18 dhe pastaj do ju pyes në qoftë se ju rifreskon memorien nëse
19 ju kujtohet diçka lidhur me këtë.

20 "PY. Në deklaratën e 2020, ju thatë që Sadik Halitjaha
21 urdhëroi Agim Zybën dhe Naim Kadollin që të shoqëronin Latifën
22 dhe Rushen në brigadë. Ju thatë që Agimi dhe Naimi ishin
23 policë ushtarake në Budakovë dhe që ju nuk e dini se çfarë i
24 ka ndodhur Latifës dhe Rushes më pas".

25 A keni qenë i pranishëm kur i është dhënë ky urdhër

1 Agimit dhe Naimit?

2 "PË. Jo.

3 "PY. Atëherë nga e dini ju që ka ekzistuar një urdhër i
4 tillë për t'i çuar?"

5 Ju më pas thoni në përgjigjen:

6 "E di që e kanë çuar ata atje, sepse kur janë kthyer
7 policët kanë tregu që i kanë çu poshtë".

8 "PY. Policia, kur janë kthyer policët që i kanë dërguar
9 poshtë ku e kanë përmendur që i kanë dërguar?

10 "PË. Nuk e di. Mund t'i pyesni ata. Ata thanë që i kanë
11 dërguar në brigadë. Kaq kanë thënë.

12 "PY. Këtë jua ka thënë Agim Zyba dhe Naim Kadolli?

13 "PË. Po".

14 Dëshmitar, a mund t'i thoni Gjykatësve në qoftë se kjo
15 pjesë që sapo ju lexova është e saktë, apo jo?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtojmë sepse kjo ka të bëjë
17 me paragrafin 6 të Shënimit Përgatitor numër 1 që u ofrua për
18 sa i takon vërtetësisë së përmbajtjes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtohet
20 kundërshtimi.

21 Mund të vazhdoni.

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, pyetja ime ishte kjo: A ju kujtohet që ia keni
24 thënë këtë informacion Prokurorisë dhe a është e saktë ajo që
25 sapo ju lexova?

1 PË. Unë s'e di kësaj pyetje ju kam përgjigj edhe më herët.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
3 përgjigjuni pyetjes tani.

4 DËSHMITARI: E thashë unë edhe më herët. Po se kush i ka
5 dhënë urdhër mundeni me i pyet ata. Edhe këtë e kam thënë më
6 herët se Agim Zyba dhe Naim Kadolli, kush i ka dhënë leje
7 atyne, kush i ka këshillu me i çue e ku me i çu, ata e dinë.
8 Unë nuk e di se unë s'kam marrë pjesë në transportin e tyre.
9 Këtu po shkrun eskortën, transportin, kështu s'kam njohuri.

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, unë po përpiqem që të më sqaroni në qoftë se,
12 sikurse keni thënë ju në intervistën me ZPS-në, Agim Zyba dhe
13 Agim Kadolli të kanë thënë që atë e kanë dërguar Latifën dhe
14 Rushen në brigadë. Po të pyes a është e saktë kjo, apo jo
15 çfarë i ke thënë ZPS-së në intervistë nuk është e vërtetë.

16 PË. Ku i kanë çu ata unë s'kam ide. Po e di që ata i kanë çu,
17 se ata kanë qenë ata që i kanë çu ato. Ata vetë e kanë marrë
18 atë detyrë.

19 PY. Për ta sqaruar, ju e dini që ata e kanë dërguar këto dy
20 gratë diku sepse sikurse thënë në intervistën e ZPS-së, Zyba
21 dhe Kadolli ju kanë thënë që i kanë dërguar diku ato apo e ke
22 marrë vesh në ndonjë mënyrë tjetër këtë gjë?

23 PË. Zyba dhe Kadolli.

24 PY. Pyetja e fundit. Po thoni që Zyba dhe Kadolli të kanë
25 thënë ty që i kanë dërguar apo i kanë transferuar Latifën dhe

1 Rushe Kolollin diku tjetër, këtë po thoni, e saktë është kjo?

2 PË. S'po di qysh diku tjetër. S'di, s'po kuptoj kund diku
3 tjetër. Ata i kanë trasportu. Ku i kanë trasportu ata i dinë.
4 Unë nuk e di se s'kam qenë me ta. Vetëm ata të dy kanë qenë.

5 PY. Dëshmitar, është pyetje shumë e thjesht po që nuk po i
6 përgjigjeni pyetjes.

7 Z. PACE: [Përkthim] Do ta them dhe një herë tjetër nëse
8 më jep leje Trupi Gjykses.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 vazhdoni.

11 Z. PACE: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, a mund të konfirmoni se dëshmia juaj sot është
13 që Agim Zyba dhe Naim Kadolli të kanë thënë ty që ata e kanë
14 transferuar Latifen dhe Rushe Kolollin diku?

15 PË. Po.

16 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Gjykatësi Mettraux.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
20 Smith.

21 Pyetje nga Trupi Gjykses:

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar. Kam
23 disa pyetje për juve lidhur me disa prej temave të ngritura
24 nga palët.

25 Pyetja e parë që kam për ju ka të bëjë me marrëdhënien që

1 keni pasur ju anëtarë të tjerë të batalionit. Dua të jemi i
2 sigurt që e kam kuptuar si duhet dëshminë tuaj. Pyetja e parë
3 është kjo: Mesa e kuptoj unë dëshminë tuaj, ju keni pasur një
4 marrëdhënie të përgjithshme të mirë me anëtarë të tjerë të
5 Batalionit të Dytë. A është e saktë kjo, Dëshmitar.

6 PË. Po, z. Gjykatës. Marrëdhëniet kanë qenë të mira.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në veçanti nga dëshmia e
8 dhënë kuptova që keni pasur një marrëdhënie besimi me Sadik
9 Halitjahën, a është e vërtetë kjo?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të cilin ju e përshkruani
12 si një shok, kështu ia keni përshkruar ZPS-së, a është e saktë
13 kjo?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ashtu gjatë seancave
16 përgatitore ju keni thënë që ju keni ndjekur të paktën një
17 pjesë të dëshmisë së dhënë prej tij të dhënë në këtë gjyq, apo
18 jo, Dëshmitar?

19 PË. Do sekuenca. S'e kam ndjek krejt.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj që na keni thënë
21 që keni pasur një marrëdhënie përgjithësisht të mirë me
22 pjesëtarët e ushtrisë e policisë ushtarake në batalion në
23 verën e 1998, në mos gabohem juve përmendët fjalën që kemi pas
24 një marrëdhënie të respektit të ndërsjellë. A është e saktë
25 kjo, Dëshmitar?

1 PË. E vërtetë është.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do ishte e njëjta gjë e
3 vërtetë edhe me z. Sadri Emerllahu, domethënë, që keni pasur
4 marrëdhënie të mirë me të gjatë kohës kur keni qenë në UÇK?

5 PË. Po, kemi pas marrëdhënie të mira, me ë gjithë, jo veç me
6 Sadrien, me të gjithë.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, do t'ju pyes lidhur
8 me dy incidente me dy raste për të cilat u pyetët edhe nga
9 palët e tjera. Rasti i parë ka të bëjë me Latife dhe Rushe
10 Kolollin dhe rasti tjetër ka të bëjë me Fetah Rudin. Do filloj
11 me dy gratë Kololli.

12 Ju thatë që jeni në dijeni ose keni informacion të atij
13 rasti dhe që në fakt jeni takuar me këto dy gratë Kololli
14 ndërkohë që ato ishin të ndaluara nga UÇK-ja, a është e
15 vërtetë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, kam bisedu to.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thatë që i keni pyetur ato
18 në veçanti për pretendimet që ishin ngritur kundër tyre se ato
19 ishin spiune të Serbisë, a është e saktë kjo?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa dini ju, përveç jush
22 a ka pasur ndonjë person tjetër që i ka marrë në pyetje Latife
23 dhe Rushe Kolollin lidhur me këto pretendime që ato ishin
24 spiune apo ju keni qenë personi i vetëm që i keni pyetur ato?

25 PË. Jo, unë kam qenë i vetëm. Sa di unë kërrkush tjetër s'i

1 ka marrë, s'ka bashkëbisedu tjetërkush përveç meje.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbase po ua propozoj këtë
3 duke ju konsideruar dhe si avokat, por praktika normale është
4 që kur dikush ndalohet, sepse ka dyshime se mund të ketë kryer
5 një vepër penale, ky person duhet të ketë një person
6 përgjegjës që ta marrë në pyetje personin e ndaluar dhe në
7 këtë rast ju do të kishit qenë ky person, apo jo?
8 PË. Po unë ka qenë si këshilltar ligjor dhe që i kam njoft
9 rregullat më mirë, për atë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thatë një herë që jeni
11 këshilltar ligjor, po atëherë në çfarë cilësie keni e
12 intervistuar një person që dyshohej se kishte kryer ndonjë
13 vepër penale? Sepse në atë rast ju s'i keni dhënë këshilla
14 ligjore Latife dhe Rushe Kolollit, kështu që unë po ju pyes në
15 çfarë cilësie keni ndërhyrë në atë proces? Nëse mund të na
16 ndihmoni në lidhje me këtë pyetje, do e vlerësojmë.

17 PY. Nuk po kuptoj. Po mendoni sikur në paqe me vet a doni
18 avokat, a doni kësi? Se unë s'kam qenë gjyqtar aty, as kam
19 qenë hetues. Unë thjesht kam bashkëbisedu me to edhe kam
20 propozu mendimin tem e kam dhënë që ato nuk kanë kurrfarë faji
21 dhe të lirohen. Q'kaq. E thashë edhe më parë na s'kemi pas, se
22 shumë po aludohet rreth gjykatës ushtarake, s'ka pas gjykatë
23 ushtarake askund. S'ka pas mundësi a s'ka pas resurse, a s'ka
24 pas njerëz, s'ka pas mjete. Vetëm një ambicie për të ekzistuar
25 një organ i tillë në atë kohë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur thoni "bashkëbiseduam"
2 ju, në fakt, atyre ju keni bërë pyetje? S'ju kanë bërë ato
3 pyetje ju. Ju u keni bërë pyetje dhe ato përgjigjeshin,
4 kështu?

5 PË. Po, normalisht.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po s'ishin të lira të
7 largoheshin, apo jo?

8 PË. Të lira kanë qenë të largoheshin mbasi e kemi kry
9 bashkëbisedimin ato kërrkush s'i ka mbajt aty si ka urdhnuë.
10 Kurrfarë urdhni s'kanë pas ato. Vetëm që janë ndalu, janë
11 legjitimu nga persona të caktum edhe janë sjellë ato, janë
12 intervistur, si të them, bashkëbisedu. Dhe është kry kjo
13 procedurë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flas edhe për atë që ju
15 ka ndodhur. Por gjatë kohës që u morët në pyetje ato nuk ishin
16 të lira të largoheshin, apo jo?

17 PË. Po kur bashkëbisedon dikush, nuk është e udhës tash me çu
18 e me u largu ajo ose me u largu unë. Na bisedë kemi bë. Gjatë
19 bisedës s'mund me u largu askush në qoftë se don me bisedu.
20 S'di sa jam i kjart, z. Gjykatës. Bashkëbisedimi bëhet mes dy
21 vetëve. Në qoftë se njëni çohet atëherë s'ka bashkëbisedim.

22 Kështu që ne e kemi kry bisedën edhe me vullnetin e atyne
23 edhe me vullnetin tim, kështu që me i sqaru disa gjena edhe
24 kemi ardhë në konkludim s'kemi të bëjmë me asgjë me atë çka po
25 predikohet.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në dëshminë tuaj ju
2 po thoni që Latife dhe Rushe Kololli ishin të lira të çoheshin
3 në çdo moment gjatë bashkëbisedimit me ju të dilnin nga dhoma
4 dhe shkonin në shtëpi? Kjo është dëshmia juaj?

5 PË. Jo, ato pa e kry bashkëbisedimin qysh me u çu? Është kry
6 bashkëbisedimi edhe janë liru.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë do të flasim pak më
8 vonë për këtë.

9 Kush ta dha këtë përgjegjësi, kush ta dha përgjegjësinë
10 që të bisedoje me gratë Kololli?

11 PË. Po, përgjegjësinë unë e kam pas në momentin kur jam emru
12 si këshilltar juridik.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në atë pozitë ju ka
14 emëruar Sadik Halitjaha sipas asaj që na thatë?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në fakt, ju keni
17 ushtruar autoritetin e tij. Është e drejtë kjo, është një
18 parashtrim i saktë?

19 PË. Po tash q'ashtu diçka duhet me qenë autoriteti,
20 autorizimet gjatë në kuadër të autorizimeve që kanë pas.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duhet t'ju pyes sërish si
22 avokat. Ju keni marrë në pyetje dy persona që dyshohet se
23 kishin kryer vepra penale të rënda. Ju personalisht çfarë
24 autoriteti ligjor kishit për t'i marrë në pyetje këto dy
25 persona ose më saktë çfarë dokumentacioni, çfarë burimi ligjor

1 përdorët ju për të marrë në pyetje këto dy gratë, mbi ç' baza
2 ligjore e kryet këtë?

3 PË. Në bazë të vendimit që jam emnue si këshilltar ligjor nga
4 brigada -- nga batalioni.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por Z. Halitjaha çfarë
6 autoriteti kishte për t'ua dhënë kompetencën? Më saktë, ku e
7 bazonte z. Halitjaha autoritetin e tij për të të emëruar ty që
8 të merrje ë pyetje të dyshuarit?

9 PË. Z. Halitjaha ka qenë komandant i batalionit, e kemi thënë
10 një qind herë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj unë atë. Po ju
12 pyes si jurist, ju vetë si jurist, në atë kontekst konkret mbi
13 ç' baza, sipas jush, mbi ç' baza mund të të thoshte ty z.
14 Halitjaha ti e ke kompetencën apo ke përgjegjësi të marrësh në
15 pyetje personat që dyshohen për krime? Sepse që të lëshonte
16 një urdhër ai për një gjë të tillë duhet të kishte autoritet.
17 A e kishte ai një autoritet të tillë?

18 PË. Po, normalisht që e kishte. Në atë brigadë s'ka pas
19 kërrkush autoritet tjetër, në atë batalion mendoj se po e
20 përziq me brigadën.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe unë tani po ju pyes
22 atij kush ia dha këtë autoritet, këtë kompetencë?

23 PË. S'e di unë. S'kam ide.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në përmbledhje ju
25 keni marrë në pyetje personat bazuar në urdhër të z. Halitjaha

1 pa pasur kurrfarë ideje se nga e gjente ai kompetencën?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të ishte përgjigja juaj
4 e njëjta nëse unë do ju pyesja lidhur me autoritetin për
5 ndalimin e personave? Ku e gjeti ai këtë kompetencë, këtë
6 autoritet?

7 PË. Unë e thashë edhe më herët, nuk është ndalim është
8 legjitimim i personave që hyjnë në zonën e luftës, legjitimim
9 ose më thjeshtë me thanë identifikim të personit të panjohur
10 që hyn në zonën e luftës ku na kemi pas kontrollin edhe
11 personat si të dyshimtë normalisht janë edhe --

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'ju ndërpres këtu,
13 zotëri. Gratë Kololli nuk hynë në territorin e askujt. Ato
14 ishin aty. Ato ishin në territor që kontrollohej prej UÇK-së,
15 apo jo?

16 PË. Jo, s'kanë qenë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po thoni që ishin të lira
18 për t'u larguar. Atëherë nëse nuk ishin të ndaluara dhe ishin
19 të lira, ju po thoni që ishin të lira të largoheshin g'atë
20 kohën që ishin nën kontrollin e UÇK-së në duart e UÇK-së. Kjo
21 është dëshmia juaj?

22 PË. Jo. Pas intervistimit -- pas bashkëbisedimit.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë unë i kthehem
24 pyetjes. Ku buronte ky autoritet, pra, ku buronte ky autoritet
25 ose kjo kompetencë për të ndaluar civilët, personat që

1 dyshoheshin si spiunë në këtë rast, mbi ç'bazë ligjore, mbi
2 ç'burim ligjor mbështetëj kjo kompetencë?
3 PË. Kjo e drejt i është dhënë nga shtabi i batalionit të
4 Budakovës. Edhe ky urdhër ose ky, qysh me thënë, kjo urdhëresë
5 është urdhëresë e përgjithshme e pashkruar që çdo person që
6 tenton me hy në territorin ku e ka kontrollu batalioni duhet
7 të identifikohet ose që del. Ka pas raste që edhe mu më kanë
8 identifikuar se s'më kanë njoft kur kam qenë në shtëpi ose kam
9 qenë për ndonjë ujkend kur kam hy mi kanë lyp identifikimin
10 Kush je ti? Nuk është e thënë me të njoft krejt batalioni ose
11 kështu që ata e kanë pas për detyrë me urdhën të përgjithshëm
12 të shtabit që personat e panjohur të identifikohen, të
13 legjitimohen dhe thjesht të dihet se ka mund me hi dikush i
14 padëshirueshëm.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndaloni. Ndaloni, ju
16 lutem, Dëshmitar. Dua të jem i qartë që të marrim përgjigje të
17 shkurtra. Pra, po thoni që Latife dhe Rushe Kololli u
18 arrestuan sepse kanë hyrë në territor që ishte nën kontrollin e
19 batalionit për këtë arsye janë ndaluar. Kjo është dëshmia
20 juaj?

21 PË. Nuk janë ndaluar, janë identifikuar, prapë po e them mu
22 për atë. Kanë hy në territor të luftës dhe kanë pas
23 thashetheme që ato nuk janë thjesht të pastërta në këtë
24 aspekt.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani pretendimet mesa po

1 kuptoj unë nga dëshmia juaj, kanë qenë se ato akuzoheshin për
2 spiunazh me serbët dhe ju i morët në pyetje dhe sipas jush
3 s'kishte kurrfarë baze për këto akuza dhe, mesa besonit ju,
4 ato thjesht ishin të përfshira në veprimtari prostitucioni,
5 kështu?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani pyetja ime është kjo:
8 UÇK-ja kishte ndonjë ligj që e ndalonte prostitucionin nëse ka
9 qenë ky rasti? Domethënë kjo s'mund të jetë arsye për të
10 ndaluar një person në UÇK?

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po për të legjitimuar
12 është arsyeja e secilit person që hyn në zonë të uftës me
13 legjitimi jo me ndalu. Secili person që hyn edhe mu më kanë
14 legjitimu kur kam hy s'ka pas kurrgjë të keqe. Ato kanë
15 nxjerrë thashetheme që ato nuk janë të përshtatshme, muj me bë
16 ndonjë spiunazh, sene, q'ato janë bë. Kurrgjë tjetër.
17 Prostitucionin ne nuk e kemi ndal. Unë për atë kam thënë janë
18 të pafajshme dhe mund me shku ato me ushtru veprimtarinë çka
19 atyne ju pëlqen. As sot nuk është prostitucioni i ndalum.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do bëj
21 ndërprerje të shkurtër. Mu kujtua që mbase mund të kemi ndonjë
22 paqartësi mes legjislacionit vendas dhe të drejtën humanitare
23 ndërkombëtare për ndalimin e personave për arsye sigurie.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Emmerson, mos i bëni
25 këto parashtrime në sy të dëshmitarit. Kur të bëni pyetje

1 plotësuese mund ta pyesni ju dëshmitarin nëse ka pas ndonjë
2 bazë ligjore të mëtutjeshme. Është vendimi juaj, por ky është
3 parashtrimi im, z. Emmerson.

4 Po bëj pyetjen në fakt që i intereson z. Emmerson.

5 Kur arrestonit ose ndalonit persona, e lëmë mënjanë
6 rastin që sapo diskutuam, sipas jush, ju po respektonit të
7 drejtën humanitare ndërkombëtare në ushtrimin e këtij
8 aktiviteti?

9 PË. Patjetër.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Cila dispozitë ka qenë
11 baza për këtë qëllim?

12 PË. Duhet t'ua them dispozitën? Është --

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse mundesh mirë. Nëse
14 s'mundesh mund të na thuash që nuk mundesh.

15 PË. E drejta e mirësjelljes, e drejta trajtimit të barabartë,
16 e drejta -- të gjitha janë ato të drejta të garantuara qoftë
17 me ligje ndërkombëtare qoftë me ato vendore. Na ligje vendore
18 s'kemi pas atëherë. Normalisht që u është dasht me u mbështet
19 edhe në konventa ndërkombëtare, në konventat e luftës. Krejt
20 ato janë kanë. I kemi inkorporu me një fjalë, i kemi bash
21 dyjëzu se ato janë kanë qëllim mirë edhe sot janë qëllim mirë.
22 Pa marrë parasysh kur hyn në zbatim.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

24 Të flasim sërish për gratë Kololli. Në intervistën që
25 keni dhënë ZPS-së, si dhe në deklaratën për UNMIK-un - është

1 intervista me ZPS-më Pjesa 3, faqja 15, që është tashmë prova
2 materiale P1136 dhe deklaratë e UNMIK-ut P1135 në faqen 2 - ju
3 thatë që pasi përcaktuat se sipas jush s'kishte baza për
4 sugjerime që ishin bërë se gratë Kololli ishin spiune, shkuat
5 te Sadik Halitjaha, komandant i brigadës dhe i thatë se, sipas
6 jush, ju i propozonit komandant të batalionit t'i lironin ato
7 gratë ose t'i çonin te brigada. A ju kujtohet kjo?

8 PË. Qe, unë kam bisedu me këta dy që i kanë pas me i dorëzu,
9 me i --

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, jo, jo, Dëshmitar. Unë
11 po ju them çfarë keni thënë ju te intervista me ZPS-në dhe unë
12 po jua lexoj:

13 "Çfarë ju shtyu të besonit se ishin prostituta?"

14 Kjo është pyetja.

15 Përgjigje:

16 "Për shkak të mendimit që kishin shprehur
17 bashkëfshatarët, fqinjët që jetonin pranë tyre".

18 "PY. Dhe kur i propozuat komandantit të batalionit t'i
19 lironin ose t'i çonin te brigada, këtë propozim ua bëtë me
20 shkrim apo me gojë?"

21 "PË. Po. komandantit të brigadës, brigadës --
22 komandantit të batalionit.

23 "PY. Bëhet fjalë për Sadik Halitjahën?"

24 "PË. Po, kështu".

25 Kjo është deklarata që i keni dhënë ZPS-së.

1 Ndërsa tek deklarata për UNMIK-un në faqen 2, ju thoni:

2 "Në fund dola në përfundimin që ato ishin thjesht
3 prostituta të nivelit më të ulët dhe i propozova komandantit
4 të batalionit t'i lironte ose t'i çonte te brigada për
5 procedura të mëtutjeshme".

6 Pra, në intervistën me ZPS-në, por edhe në intervistën që
7 keni pasur me UNMIK-un, e keni thënë qartazi se në momentin që
8 dolët në përfundimin se s'kishte asnjë bazë për akuza se ishin
9 spiune shkuat tek Sadik Halitjaha për t'i paraqitur propozimin
10 tuaj. I qëndroni këtyre dëshmime apo doni t'i ndryshoni?

11 PË. Unë kam bisedu dhe me ZPS-në javën e kalume. Unë
12 gjithmonë kur i kam përmend Sadik Halitjahën kam mendu në
13 shtabin e batalionit se gjithmonë është personifikue si shtabi
14 i batalionit. Shtabi i ka pas disa anëtarë dhe ata sigurisht
15 që kanë vendosë një zërit ose kanë vendosë për to.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që të jemi të qartë. kur
17 flisni për komandantin e batalionit, ju nuk po e ndryshoni
18 këtë, pra, ju po thoni që pra, ju po thoni që kur i referoheni
19 batalionit nuk e keni fjalën konkretisht për Sadik Halitjahën
20 po për këdo që ishte pjesë e atij shtabi. Kjo është dëshmia?

21 PË. Për shtabin po. Për shtabin.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse në intervistën me
23 ZPS-në Pjesa 3, faqja 17 dhe në intervistën me UNMIK-n ju
24 vijoni e thoni, pyetje e ZPS-së:

25 "Sa i takon Latife dhe Rushe konkretisht çfarë tha Sadik

1 Halitjaha kur i propozove që t'i lironte apo t'i çonte në
2 brigadë?"

3 "PË. Po, po, vazhdojmë kështu."

4 "PY. Po çfarë t'i lironit apo t'i çonit në brigadë?

5 "PË. Ti çonim atje poshtë në brigadë".

6 Pra, në intervistën me ZPS-në duket sikur ke folur me z.
7 Halitjaha dhe kanë qenë fjalët e tij këto. A pajtoheni me
8 këtë?

9 PË. Po tani nuk po më kujtohet që kam biseduar me të. Po siç
10 e thashë, është propozimi jem që të lirohen ato dhe s'ka pas
11 kurrfarë procedure tjera. Mendimi jem ka qenë që ato nuk kanë
12 kurrfarë të bëjnë diçka me spiunazh siç është edhe pretenduar
13 nga popullata. Se popullata e atyshme i ka njoft. Se ato kanë
14 qenë të atij vendi. Hyrja-dalja në polici ka ngrit dyshimet.
15 Po ma vonë, në bazë të bashkëbisedimit është konstatuar se ato
16 nuk kanë pas kurrfarë qëllimi të ndonjë spiunazhi po thjesht
17 ka qenë për qëllime të ulta morale.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju ndaloj këtu. Ju po
19 thoni tani që nuk ju kujtohet kjo bisedë me Sadik Halitjahën,
20 këtë po thoni?

21 PË. Po Sadik Halitjaha s'ka qenë gjithmonë në batalion. Nuk
22 ka qenë gjithmonë. Ai ka qenë edhe në udhëtime, ka qenë nëpër
23 territorin e batalionit. Ka pas edhe obligime tjetër siç e
24 thashë furnizime, kontrolla --

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ju përgjigjët pyetjes

1 sime. Pra, dëshmia juaj tani është që ju nuk ju kujtohet të

2 keni pasur këtë bisedë me Sadik Halitjahën?

3 PË. Mund të ketë qenë, po mu s'më kujtohet. Thjesht. Se s'ke

4 mujt me u taku me Sadikun ti sa herë ke dash. Se ai ka qenë me

5 obligime tjera.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohin informacionin që

7 kemi në lidhje me këtë.

8 I lutem Sekretares të nxjerrë në ekran materialin

9 SITF00032782.

10 Përpara, pra, në ekran është deklarata e Naim Kadolli, të

11 cilin e keni përmendur disa herë dhe keni thënë që ka qenë një

12 prej dy anëtarëve të UÇK-së që shoqëroi Latife dhe Rushe

13 Kolollin, kështu?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në atë kohë Naim Kadolli

16 ka qenë anëtar i policisë ushtarake në nivel batalioni, saktë?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në fillim të 1998,

19 fillimi i 1999, u bë zëvendësshefi i ZKZ-së, S-2, në nivel

20 batalioni. E dini këtë?

21 PË. Jo. Kurrë s'kam dëgju.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Deklarata mban datën 6

23 tetor 2002. Pak vite pasi kishte ndodhur ngjarja. Dhe dua të

24 shohim bashkë disa nga gjërat që ka thënë z. Kadolli dhe që

25 janë hedhur në këtë dokument.

1 Dhe do shohim pak më poshtë në tekst.

2 Ju kërkoj falje se nuk e kemi në shqip të përkthyer këtë,
3 prandaj unë do ta lexoj me zë. Së pari, ai shpjegon çfarë roli
4 ka pasur në verën e 1998. Thotë që:

5 "Fillova në UÇK qysh në fillim të qershorit të 1998 dhe
6 shërbeva deri në fund të luftës.

7 "Shërbeva tek Batalioni i Dytë i Brigadës 123 fshatin
8 Budakovë.

9 "Komandant batalioni ka qenë Sadik Halitjaha.

10 "Kishim vetëm një uniformë por një herë unë shërbeva si
11 polic ushtarak".

12 Dhe thotë:

13 "Në fillim shërbeva si polic ushtarak dhe më pas isha një
14 ushtar i thjesht".

15 PO ndaloj një moment këtu. A përputhet kjo me kujtesën
16 tuaj sa i takon Naim Kadollit deri në këtë moment kohor, ka
17 qenë kështu?

18 PË. Nuk e di unë. E di që ka qenë si polic ushtarak. Policëve
19 ushtarak ne i kemi thënë si njësit për ndërhyrje të shpejt,
20 njerëz pak më të aftë më të zhdërvjellët, më të zgjedhur.

21 Atyne e kanë pas edhe epitetin e policit ushtarak përndryshe
22 ata kanë qenë për ndërhyrje të shpejtë. E sa i përket që thotë
23 më poshtë se "kam qenë pastaj ushtar i thjesht", unë nuk di.

24 Mund ta pyetni atë. S'muj me u përgjigj për të.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas e pyesin:

1 "A i dini emrat e Latife dhe Rushe Kolollit?

2 "PË. Po më kujtohet për çfarë rasti po flisni. Më
3 kujtohet rasti po s'i njoh me emra".

4 Pastaj bëjnë pyetje:

5 "Kur i ke parë ato për herë të parë dhe kur ke dëgjuar
6 për to për herë të parë dhe në ç'kushte keni parë apo dëgjuar
7 për to?

8 "PË. Për herë të parë i kam parë kur është dhënë urdhër
9 nga komandanti i batalionit, ka qenë urdhër i dokumentuar, një
10 dokument me shkrim, pra, për mua dhe Agim Zybën t'i shoqëronim
11 nga Budakova për t'i çuar në brigadë".

12 E kuptoni?

13 PË. Shumë mirë paska thënë ai. E paska sqarue që paska pas
14 urdhër. S'kam çka me interpretu deklaratën e atina.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe thotë që urdhri ka
16 ardhur nga komandanti i batalionit, siç i ke thënë edhe ti
17 ZPS-së në intervistën tuaj, pra, që urdhri për arrestimin e
18 Latife dhe Rushe Kolollit ka ardhur nga z. Halitjaha, saktë?

19 PË. Jo, për arrestimin s'ka ardhë se ato s'janë arrestu.
20 Prapë po e them unë, nuk janë arrestu. Janë identifiku. Dhe
21 urdhër Sadiki s'ka dhënë. Ka qenë urdhër i përgjithshëm i
22 batalionit se kush hyn njeri i pidentifikuar të identifikohet
23 në zonë të luftës. Këto kanë qenë të përfolura dhe janë
24 ndalue, janë legjitimue. Sadik Halitjaha nuk i ka njoft këto.
25 Urdhri i përgjithshëm është i batalionit që kush të hyn në

1 zonë të luftës të identifikohet, t'ia lypin letërnjoftimin,
2 pasoshin, çka kanë.

3 Në qoftë se dyshon dikush atëherë duhet të
4 bashkëbisedohet me ta. Kjo ka qenë se s'ka pas -- Sadiki s'i
5 ka njoft, as unë s'i kam njoft, as kërrkush s'i ka njoft. I
6 kanë njoft qytetarët ku na pas kemi veprue.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në 2002 i keni thënë
8 kështu UNMIK-ut. Për procesverbal është prova materiale P1135,
9 faqja 2. Në mes të faqes. Ju kanë pyetur lidhur me arrestimin
10 e Latife dhe Rushe Kolollit, pyetja është kjo:

11 "Kush e ka dhënë urdhrin për arrestimin dhe për çfarë
12 arsyeje u arrestuan?"

13 Përgjigje e juaj:

14 "Urdhrin për arrestim e ka dhënë Sadik Halitjaha,
15 komandant batalioni. Kishte dyshime se bashkëpunonin me forcat
16 serbe, me policinë serbe, me forcat armike".

17 I qëndroni dëshmisë që urdhri për arrestimin ka ardhur
18 nga Sadik Halitjaha, siç e keni thënë dhe në 2002 apo doni ta
19 ndryshoni këtë dëshmi?

20 PË. Jo, që dy me ndryshu, po s'është reale ajo. Qysh është
21 lëshue ajo nuk e di se unë prapë po them Sadik Halitjaha nuk i
22 ka njoft këto. S'i ka njoft. As unë si kam njoft. As Naim
23 Kadolli s'i ka njoft. Këto i kanë njoft popullata aty ku kemi
24 nejt na. Budakova. Na s'kemi pas ide kush janë këto.

25 Posaçërisht Sadiki ka ardhë prej Zvicrës sa 10-15 vite

1 s'ka qenë në Kosovë po i njef ato apo dikënd tjetër. S'ka pas
2 shans me i njoft. Sadiki as 10 për qind s'i ka njoft
3 popullatën. Po urdhri ka qenë i përgjithshëm. Unë ju thashë
4 përsëri po e them po e përsërit ndoshta po bëna i tepërt,
5 urdhri ka qenë si urdhër i komandës së batalionit.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, e keni thënë. E keni
7 thënë.

8 PË. Po ashtu është pra.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk është nevoja ta
10 përsërisni.

11 PË. Okej.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim materialin
13 SITF00032782 që është deklarata e Naim Kadollit.

14 Në fund të kësaj faqeje i kanë bërë një pyetje:

15 "A e dini kush i arrestoi ..."

16 Bëhet fjalë për dy gratë Kololli.

17 "... dhe i çoi në Budakovë?"

18 Përgjigje:

19 "Kam dëgjuar që Musë Qerkian i ka arrestuar".

20 Kështu ju kujtohet dhe ju që ka qenë Musë Qerkinaj?

21 PË. Ashtu e kam edhe unë të dëgjune. Ashtu edhe unë e kam të
22 dëgjune, përndryshe s'e kam pa. Me Musën nuk kam bisedu unë.
23 Po kanë thanë që Musë Qerkini i ka ndalue i ka legjitimu.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Musa ka qenë i policisë
25 ushtarake, kështu?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër të
3 dokumentit. Këtu e kanë pyetur z. Kadolli se:

4 "A e keni idenë sa kohë u mbajtën këto gratë në
5 Budakovë?"

6 Ai i është përgjigjur:

7 "Me sa di unë rreth 24 orë".

8 A ju kujtohet dhe ju kështu se rreth sa orë kanë qëndruar
9 ato në Budakovë pasi i morën?

10 PË. Unë e mendoj më pak që kanë qëndru.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më poshtë në tekst e
12 pyesin:

13 "Sa persona keni shoqëruar tek shtabi në Nishor" dhe këtu
14 është "kush ju priste?"

15 "Fillimisht" thotë ai "dua t'ju sqaroj një gjë, nuk i
16 çuam tek shtabi në Nishor por i lamë në fshatin Semetishtë. Në
17 atë fshat dërguam tri persona, këto dy gratë dhe Sulejman
18 Kokollarin. Me mua ishte Agim Zyba. Në fshatin Semetisht na
19 ndaluan një grup ushtarësh dhe atje njoha Naim Berishën. E
20 pyetëm për shtabin e brigadës dhe i thamë se kemi tre të
21 burgosur për atje. Ai na u përgjigj se nuk kishim të drejtë ne
22 ta dinim se ku ndodhej shtabi i brigadës. Dhe i mori ai të
23 burgosurit nën përgjegjësinë e tij, për t'i dërguar në shtabin
24 e brigadës. Nënshkroi dokumentin se mori të burgosur nën
25 përgjegjësinë e tij në dorëzim. Më pas ne u kthyem në

1 Budakovë. Më duhet të them se Naimi kishte shenjën M.P në
2 shpatull. Ai ishte bashkë me tri-katër ushtarë të tjerë po unë
3 nuk njoha asnjë prej tyre. MP, domethënë, policia ushtarake”.

4 Naim Berishën e njihni i brigadës?

5 PË. Jo, s’e njoh. S’kam nejt kurrë unë me ta as e kam pa, po
6 kam dëgju për të. Përndryshe kurrë se kam njoft as përpara.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni dëgjuar nga Naim
8 Zyba dhe personi tjetër, pra, Naim Kadolli, kur keni folur me
9 të, që ata i kanë lënë dy gratë Kololli ia kanë lënë Naim
10 Berishës në Brigadë dhe z. Kokollari?

11 PË. S’kam ide. S’kam kurrfarë njoftimi lidhur me këtë gjë.
12 Ata sigurisht i dinë më mirë. E paskan deklaruar vetë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim pak se çfarë ka
14 thënë personi tjetër që i ka shoqëruar Agim Zyba, çfarë ka
15 thënë në vitin 2002. Për procesverbal, është dokumenti
16 SITF0032792.

17 Ajo çfarë do shihni përsëri është një deklaratë e UNMIK-
18 ut e datës 24 gusht 2002, është deklarata e Agim Zybës.
19 Thjesht për t’ju pyetur edhe një herë tjetër, Agim Zyba ishte
20 anëtar i policisë ushtarake në batalionin tuaj në periudhën
21 qershor korrik 1998, apo jo?

22 PË. Po, z. Gjykatës.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni të faktit
24 që ai u bë pjesë e ZKZ-së dhe u bë shef i ZKZ-së dhe pastaj z.
25 Kadolli ishte zëvendësshëf. Domethënë, a e dini që më vonë ai

1 u promovua, u rrit në detyrë në nivel batalioni dhe u bë

2 drejtues i ZKZ-së? E keni këtë gjë?

3 PË. Jo. As që e kam dëgju.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani le të shohim se çfarë
5 ka thënë z. Zyba në atë kohë lidhur me këtë pikë.

6 Ai thotë:

7 "Në fillim fare isha ushtar. Pastaj u bëra anëtar i
8 policisë ushtarake. Kam vepruar në fshatin Budakovë. Nuk ishte
9 brigadë. Dhe ishte batalion. Dhe komandant i saj ishte Sadik
10 Halitjaha. Në atë kohë në fillim komandanti i brigadës ishte
11 Blerim Kuqi nga Suhareka".

12 Dhe më tej thotë që:

13 "Në Budakovë ne kemi funksionuar si batalion, në kuptimin
14 që nuk është se kishte ndonjë gjykatë të tillë në Budakovë".

15 Deri në këtë pikë a pajtoheni e dëshminë e dhënë nga z.
16 Zyba lidhur me rolin e luajtur prej tij edhe vendndodhjen e
17 tij?

18 PË. Po ai e din më mirë. Po kjo po i përket asaj, sa di unë
19 nuk ka farë kundërshtimi, se ka qenë edhe Sadiki ka qenë
20 komandant edhe Blerim Kuqi ka qenë komandant i brigadës
21 Suharekës.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas ai thotë, domethënë
23 i bëhet një pyetje atij në qoftë se ju njef juve. Domethënë,
24 pyetja që ju bëhet është:

25 "A e njihni Nuredin Abazin dhe çfarë detyrash ka pasur

1 ai?"

2 Ai përgjigjet si më poshtë:

3 "Nuredin Abazi ka qenë në Budakovë edhe ai ishte pjesë e
4 policisë ushtarake sepse ai ishte personi më i shkolluar
5 ndërmjet të gjithë neve. Ai ka punuar gjithashtu si
6 këshilltar. Ai kishte diplomë juridiku nga Universiteti i
7 Prishtinës."

8 Pyetja që kam për ju është kjo:

9 "A e keni idenë se mbi çfarë baze thotë z. Zyba që ai e
10 kishte kuptuar që ju ishit anëtar i policisë ushtarake, ku e
11 ka mbështetur këtë gjë z. Zyba?

12 PË. Nuk kam ide. Unë s'kam qenë pjesë e policisë ushtarake
13 kurrë unë. Kam qenë vetëm këshilltar. Është e vërtetë që kam
14 pas diplomën universitare. Tjetër sen? Polic ushtarak s'kam
15 qenë kurrë. Ushtar i thjesht po. Para së gjithash kam qenë
16 ushtar, pastaj këshilltar ligjor.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem përsëri
18 rolit tuaj për një çast. Megjithatë për momentin dëshiroj që
19 të shikojmë faqen 3 të të njëjtit dokument që kemi në ekran.
20 Për procesverbal është dokumenti SITF00032794. Të shikojmë pak
21 më lart, më sipër në faqe. Edhe pak fare më lart.

22 Unë nuk kam të njëjtën faqe në fakt. Edhe një herë po ju
23 jap numrin e identifikimit të faqes, është SITF00032794.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në qoftë se ju ndihmon, dua të
25 them që dokumenti është i gabuari ky që kemi këtu përpara në

1 ekran. Është dokumenti i mëparshëm.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ke të drejtë z. Roberts.

3 Faleminderit. Edhe një herë është faqja e parë e dokumentit që
4 kishim më herët me numër identifikimi SITF00032792. Të kalojmë
5 tek faqja e tretë.

6 Faleminderit edhe një herë, z. Roberts.

7 Të kalojmë pak më poshtë në faqe. Këtu z. Zyba pyetet:

8 "Çfarë dini lidhur me zhdukjen e dy personave Latife
9 Kolollit he vajzës së saj Rushe Kolollit?"

10 Në përgjigje ai thotë:

11 "unë e di që ato janë arrestuar diku jashtë fshatit
12 Budakovë në periudhën nga 19 deri në 22 gushti 1998. Pas
13 arrestimit ato u sollën në Budakovë dhe aty u mbajtën për 24
14 orë."

15 Së pari, më lejoni t'ju pyes lidhur me datën: A është në
16 pajtim me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me këtë rast që ky
17 rast ka ndodhur në periudhën nga 19 deri 22 gushti 1998,
18 Dëshmitar?

19 PË. Nuk më kujtohet data. S'e mbaj mend. S'kam ide.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me mua se të
21 paktën siç thuhet këtu, z. Zyba kanë thënë që gratë Kololli,
22 Latifja dhe Rushja, janë mbajtur aty, janë arrestuar dhe janë
23 mbajtur në Budakovë? E shikoni këtë pjesë që e ka thënë këtë
24 gjë z. Zyba?

25 PË. Po e shof atë çka po thoni ju se unë s'po e marr vesh,

1 kjo është gjuhë angleze. Po, prapë, po them unë që ato janë
2 identifikue. Ai paska thënë janë arrestue, nuk di qysh e ka
3 marrë, qysh e ka kuptu ai atë. Ai sigurisht nuk i ka kuptu dhe
4 termat. Po sidoqoftë deklarata e tina është.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen
6 tjetër që është SITF00032795. Kalojmë pak më poshtë në këtë
7 faqe.

8 Pyetja që i bëhet z. Zyba është kjo:

9 "Kush ju dha urdhër juve që të transportoni Latifen,
10 Rushen Kolollin dhe Sulejman Kokollarin nga fshati Budakovë?"

11 Dhe përgjigja që ai jep është kjo:

12 "Naim Kadolli dhe unë morëm urdhrin nga komandant Sadik
13 Halitjaha që t'i dërgonim të tre ata në brigadë, sepse nuk
14 kishte asnjë arsye që ata t'i mbanim në Budakovë. Rrugës për
15 atje ne u takuam me policinë ushtarake të UÇK-së, një polic
16 ushtarak të UÇK-së që e ka emrin Naim Berisha në fshatin
17 Semetishtë. Atje këta tre persona ia dorëzuar atij."

18 Së pari, Dëshmitar, a pajtoheni që duket sikur kjo dëshmi
19 është në të njëjtën linjë, pra, është e njëjta me atë çfarë ka
20 thënë Naim Kadolli lidhur me pjesëmarrjen e të dyve këtyre
21 personave dhe marrjes së këtyre dy grave dhe dorëzimit të tyre
22 tek Naim Berisha në Semetisht?

23 PË. Po ata deklaratat i kanë të njëjta se bashkë kanë qenë,
24 besoj që qashtu është. Nuk di, s'muj me të komentu, prapë po
25 them, deklaratën e tij që ka mëndu ai, po si po shifet janë të

1 njëjta se bashkë kanë qenë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ashtu është në të
3 njëjtën linjë dhe gjithsesi, domethënë, në qoftë se është e
4 nevojshme do t'i lexoj dhe paragrafët përkatës, por është
5 gjithashtu në përputhje me atë çfarë i keni thënë ju UNMIK-ut
6 dhe ZPS-së, që urdhri për t'i çuar ata në brigadë është dhënë
7 nga Sadik Halitjaha, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Po, sigurisht ata e dinë se ata e paskan bisedu unë prapë
9 po jes prapa sajna.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Juve vetë nuk ju kujtohet
11 që ishte dhe citoj:

12 "Ka qenë komandanti i batalionit Sadik Halitjaha që ka
13 dhënë urdhrin ndërkohë që ata janë shoqëruar nga Naim Zyba dhe
14 Naim Kadolli? Nuk ju kujtohet ta keni thënë këtë në
15 intervistën e ZPS-së, Pjesa 3, faqja 18, që në fakt këtë
16 urdhër e ka dhënë z. Halitjaha? S'ju kujtohet ta keni thënë
17 këtë gjë?

18 PË. E thashë edhe ma herët dhe ndoshta ka qenë ndonjë lapsus
19 po unë prapë po them që s'më kujtohet, po çka është ajo
20 relevante q'aq. Këta e dinë se këta drejtpërdrejt janë kanë të
21 involvu në atë procedurë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sigurisht që ju nuk
23 keni arsye që të vini në pikëpyetje dëshmitë e z. Zyba dhe të
24 z. Kadolli lidhur me këtë, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Po s'muj me i komentu deklaratat e huaj. Ata e dinë qysh

1 tek. S'jam kompetent me i komuniku deklaratat e huaj, as
2 shkrimet e huaja, as vendimet e huaj. Ata e dinë çfarë qëllimi
3 kanë pas dhe qysh janë. Dihet ajo.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni që pas asaj
5 çfarë duket se ka qenë një dorëzim i Latifes dhe Rushes, pra,
6 Latife dhe Rushe Kololli, për Naim Berishën në policinë
7 ushtarake, këto dy gra nuk janë parë asnjëherë më gjallë. A
8 pajtoheni me këtë, Dëshmitar?

9 PË. Si mendoj? A pajtoheni? S'e kam të kjartë pyetje.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me mua që kjo
11 ka qenë hera e fundit që këto dy gra janë parë gjallë,
12 domethënë, mbasi janë dorëzuar Naim Berishës ato nuk janë parë
13 më? A pajtoheni me këtë, Dëshmitar?

14 PË. Me pa s'i kam pa unë. Veç atëherë i kam pa. Më kurrë jo
15 s'i kam pa, as kam ni për to fare deri pas luftës. Se ka qenë
16 situatë e jashtëzakonshme. Ka qenë situatë lufte. Neve s'na ka
17 ardhë në mend për familjen tonë se leje mo për dikënd tjetër.
18 Kemi pas krejt familjet në rrezik. Unë, për shembull, familjen
19 e kam pas në fshatin Mushtishtë ku 250 shtëpi kanë qenë serbë,
20 midis serbëve e kam pas shtëpinë edhe fëmijët e mi i kam pas.
21 Nuk mujt me marr informata për ta e leje më po më interson për
22 tjerët. Ajo ka qenë me të vërtetë për me u interesu për diçka
23 tjetër ajo ka qenë shumë e zorshme. Situata ka qenë shumë e
24 rëndë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju na thatë disa herë që

1 keni pasur disa shqetësime lidhur me sigurinë e tyre,
2 domethënë, që ishit i shqetësuar sa i takon sigurisë së tyre,
3 apo jo, Dëshmitar?

4 PË. Po. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju nuk keni bërë asnjëherë
6 asnjë lloj hulumtimi, nuk jeni përpjekur asnjëherë që të gjeni
7 se ku kanë shkuar, se çfarë ndodhi me to? Domethënë, nuk është
8 se e keni pyetur asnjëherë Sadik Halitjahën apo shtabin e
9 batalionit? Nuk është se ke pyet ndonjëherë ndonjë person në
10 shtabin e batalionit se çfarë u ndodhi atyre? Ku përfunduan?
11 Ça ndodhi në përgjithësi? Kështu, Dëshmitar?

12 PË. Jo, z. Gjykatës. Nuk kam pyetur se të thashë e kam pas
13 kemi pas ne ma së pari gajlen tonë qysh do të përfundon lufta,
14 qysh do të zhvillohet, pastaj gajlen e familjes. Familja ka
15 qenë numër 1.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përderisa na thatë që ju
17 keni zbatuar të drejtën ndërkombëtare humanitare a jeni në
18 dijeni të detyrimeve të një pale në një konflikt të armatosur
19 kur i dorëzojnë një të ndaluar një personi tjetër? A e dini se
20 cilat janë këto detyrime sipas të drejtës humanitare përderisa
21 na thatë më herët që po përpiqeshit që të zbatonit të drejtën
22 humanitare ndërkombëtare?

23 PË. Po ajo ka qenë se unë thjesht kam konstatu që mendimi
24 jem, sipas mendimit tem dhe logjikës teme, kam konstatu që
25 s'kanë ato kurrgjë edhe është ju ka -- janë propzu që të

1 lirohen edhe me q'atë propozim ata i kanë çue. Tash i kanë çu
2 me siguri në një vend që ju është referu nga dikush. Dhe s'kam
3 pas unë diçka të mirrna se na kemi pas edhe punë tjera nuk i
4 kemi pas veç q'ato. Kemi qenë të ngarkum shumë me punë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me gjithë respekt zotëri,
6 nuk është përgjigje e pyetjes time. Në përgjigje të pyetjes
7 time, që është nxitur nga z. Emmerson pak më herët ju thatë që
8 të paktën unë e kuptova në nivel batalioni, pra, ju thatë që
9 në nivel në batalioni të pakën ne përpigeshim që të
10 përputheshim dhe të zbatonim të drejtën ndërkombëtare
11 humanitare.

12 Pyetja ime tani është kjo: A i njihni se cilat kanë qenë
13 detyrimet e një pale në një konflikt të armatosur kur bëhet
14 transferimi i një të ndaluarit një pale tjetër? Domethënë,
15 pyetja është shumë e thjesht. Thoni po ose jo. I dini
16 detyrimet që ekzistojnë përpara palën dorëzuese, apo jo?
17 PË. Po normalisht. I dorëzohet me i transportue në vendin e
18 preferuar por me dinjitet dhe mos me pas kurrfarë maltratimi
19 ose -- se maltratimet janë me fjalë edhe me gojë edhe me
20 vepra. Besoj që ajo s'ka ndodhë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është kjo tani,
22 a keni marrë ndonjë nga këto masa, nga këto hapa në mënyrë të
23 tillë që të siguroheshit që ato të dorëzoheshin në një vend ku
24 trajtoheshin me dinjitet dhe që të mos bëheshin objekt
25 keqtrajtimi në forma të ndryshme qofshin ato verbale ose forma

1 të tjera keqtrajtimi? A keni marrë ndonjë hap për të siguruar
2 të gjitha këto, Dëshmitar?

3 PË. Jo, s'kemi mujt, s'kemi pas kushte. S'kemi pas mundësi.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim një deklaratë
5 tjetër. Për procesverbal është SITF00032827. Është deklarata e
6 Musë Kolollit, deklaratë që i ka dhënë UNMIK-ut më 20 prill
7 2002. Fatmirësisht, zotëri, kemi edhe përkthimin në shqip të
8 deklaratës së tij, kështu që mund të shikoni dhe versionin në
9 shqip.

10 Pika e parë për të cilën do të doja t'ju pyesja dhe doja
11 që ta theksonim në qoftë se nuk e kemi thënë më përpara, në
12 qoftë se nuk e kemi theksuar më përpara, në qoftë se Musë
13 Kololli a ka qenë pjesë e policisë ushtarake në batalionin e
14 dytë në verën e 1998, është e saktë kjo, Dëshmitar, ka qenë ai
15 pjesë e policisë ushtarake?

16 PË. Po. Po, z. Gjykatës.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim atë çfarë ka
18 thënë ai në deklaratën e dhënë për UNMIK-un në 2002.

19 Ai thotë që:

20 "Në fund të qershorit 1998 ata krijuan shtabin në
21 Budakovë, por me sa di unë shtabi kryesor ishte hapur dy muaj
22 më parë në fshatin Semitisht, por nuk jam i sigurtë për këtë".

23 Ai vazhdon më tej e thotë:

24 "Shtabi lokal i krijuar me urdhër të Shtabit të
25 Përgjithshëm. Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm ishte

1 Blerim Kuqi. Komandanti i shtabit në fshatin Budakovë ishte
2 Sadik Halitjaha".

3 Më tej thotë:

4 "Unë u kyça në UÇK më 15 korrik 1998".

5 "Pas" - kalova nj fjali aty.

6 "Pas vrasjes së komandantit lokal të policisë ushtarake
7 në Budakovë Xhemajli Rexha në mes të gushtit 1998 un mora
8 përsipër atë detyrë të tijën".

9 Atëherë sa i takon kësaj pjese të deklaratës së tij, a
10 pajtoheni me të, jeni dakord me të, a mesa dini juve a mund të
11 konfirmoni që kjo pjesë e dëshmisë së tij është e saktë,
12 Dëshmitar?

13 PË. Këtu ku thotë me urdhër të komandantit të Shtabit të
14 Përgjithshëm, ju lutem, po e keqpërdorin të shtabit të
15 përgjithshëm. Shtabit të Përgjithshëm jo por të shtabit të
16 brigadës. Blerim kuqi ka qenë komandant i shtabit të brigadës,
17 nuk ka qenë i Shtabit të Përgjithshëm. S'kemi pas lidhje me
18 Shtabin e Përgjithshëm ne. Këtu unë, sipas mendimit tem,
19 Blerim Kuqi ka qenë i Brigadës 123. Edhe ai ka qenë komandant
20 i brigadës, jo Shtabit të Përgjithshëm se gjithkund po
21 përmendet Shtabi i Përgjithshëm. S'ka të bëjë me Shtabin e
22 Përgjithshëm.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj.

24 Në paragrafi tjetër thuhet si më poshtë:

25 "Më 24 gusht 1998 u zhvillua një betejë e ashpër në

1 rajonin e fshatit Semitisht dhe në disa fshatra të tjera”.

2 Ju na e thatë këtë gjë edhe më herët.

3 “Një javë më parë”, thotë ai “afërsisht nga data 15 deri
4 në 17 gusht 1998, një Musë Qerimi i policisë ushtarake i cili
5 banonte në fshatin Savrovo --

6 PË. Musë Qerkini.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar,
8 që më korrigjove.

9 “... pra, Musë Qerkini që jetonte në fshatin Sovrovë ka
10 ndaluar Sulejman Kokollarin. Musë Qerkini më ka informuar që
11 ka ndaluar Sulejman Kokollarin.”

12 Besoj që dhe kjo është ashtu siç ju thatë edhe më herët,
13 domethënë, përputhet me atë çfarë na thatë më herët, që në
14 fakt ishte Musë Qerkini ai që kishte ndaluar z. Kokollari.
15 PË. Q’ashtu.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj thotë më tej:

17 “Kur e pyeta për çfarë arsyeje më tha se kishte urdhër
18 nga komandanti Sadik Halitjaha, Musë Qerkini njoftoi
19 gjithashtu se kishte urdhër nga Sadik Halitjaha për të
20 arrestuar Latife dhe Rushen Kolollin. Rreth dy orë më vonë ai
21 i arrestoi edhe këto dy gra. Ndoshta Musë Qerkini e njoftoi
22 Sadik Halitjahën lidhur me këtë”.

23 A pajtoheni, Dëshmitar, se edhe në këtë rast kemi
24 dëshminë e një anëtari tjetër të policisë ushtarake të
25 batalionit që thotë që urdhri për të arrestuar Latife dhe

1 Rushe Kolollin kishte ardhur nga Sadik Halitjaha, siç i keni
2 thënë dhe ju më herët ZPS-së? A pajtoheni me këtë, Dëshmitar?
3 PË. Jo. Unë këtë nuk e di. Mbasi po e ditka Musë Qerkini ai
4 mund me deklarë. Unë s'di çka i ka thënë Musë Qerkinit që paska
5 dhënë urdhër Musë Qerkinit me e ndalu dikënd. Unë s'kam ide
6 për këtë. Ju thashë edhe më herët.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse në intervistën që i
8 keni dhënë ZPS-së, në faqen 4, Pjesa 3, juve ju bëhet kjo
9 pyetje:

10 "Z. Abazi, në deklaratën e 2002 që kemi diskutuar më
11 herët, ju keni thënë që keni dëgjuar që Latife dhe Rushe
12 Kololli janë arrestuar në gusht të 1998 nga Musë Qerkini,
13 mundësisht në Savrovë, pas një urdhri të dhënë nga Sadik
14 Halitjaha, sepse ekzistonin dyshime që ato bashkëpunonin me
15 policinë serbe?"

16 Dhe ju thoni:

17 "Ekzaktësisht këtë gjë kam thënë."

18 A ju kujtohet që e keni thënë këtë jo njëherë po në fakt
19 dy herë, Dëshmitar?

20 PË. Po unë e arsyetova atë çka e kam mëndu. Tash t'i
21 përsërisim përsëri apë ato. Unë e thashë shumë kjart. E këta
22 paskan informata që i ka urdhëru dikush. M'u s'më ka urdhëru
23 kërrkush, as nuk di. As që ka pasun me nevojë me më urdhnu
24 dikush me bë diçka të tillë se s'kam qënë person që kam nevojë
25 me më urdhnu dikush për punën teme që e kam bë.

1 E këta kanë qenë policë ushtarakë, ndoshta i paska
2 urdhnu. Nuk di. Nuk kam ide. Nuk kam njoftim.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse do të kalojmë tek
4 faqja tjetër.

5 Do shohim që aty thuhet që z. Musli Kololli vazhdon më
6 tej dhe thotë. Në fillim fare të faqes pasuese:

7 "Sipas urdhrit të Sadik Halitjahës tre personat e
8 lartpërmendur u çuan në Shtabin e Përgjithshëm. Unë nuk e di
9 vendin konkret. Emrat e personave që i shoqëruan ata atje janë
10 Agim Zyba dhe Naim Kadolli".

11 Besoj që pajtoheni me këtë, Dëshmitar?

12 PË. Qështu e kam të njoftun edhe unë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në paragrafin thuhet si më
14 poshtë:

15 "Gjatë kohës që ata qëndruan në Budakovë, unë e di se
16 Musë Qerkini dhe Nuredin Abazi patën një bisedë me ta. Unë e
17 di se Nuredin Abazi punon në gjykatën e Suharekës si gjyqtar."

18 A të kujtohet se kur keni biseduar me Kolollët ka qenë i
19 pranishëm edhe Musë Qerkini me këto dy gratë Kololli, a ju
20 kujtohet që ka qenë i pranishëm dhe Musë Qerkini?

21 PË. Ndoshta ka qenë. Nuk mbaj mend. Bën vaki ka qenë. S'mbaj
22 mend.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kalojmë në fund të
24 faqes. Në të dyja versionet në anglisht dhe në shqip.

25 Pyetja që bëhet është kjo:

1 "Kur u dislokua si komandant i njësisë së policisë
2 ushtarake në Budakovë gjatë luftës, sa vetë u arrestuan apo u
3 ndaluan gjatë kësaj periudhe?"

4 Përgjigja që ai jep është:

5 "Gjatë periudhës që unë isha komandant i policisë
6 ushtarake të UÇK-së në Budakovë në periudhën 15 deri në 16
7 gusht 1998 deri në fund të shtatorit 1998, personat e vetëm të
8 arrestuar ishin Sulejman Kokallari, Latife dhe Rushe Kololli.
9 Arrestimet u bënë sipas urdhrit të Sadik Halitjahës, jo timin.
10 Unë nuk e di përse ishin arrestuar këta persona. Unë nuk bëja
11 pyetje për urdhrat e Sadik Halitjahës."

12 A pajtoheni të paktën mënyrën sesi e kishte kuptuar rolin
13 e vet z. Kulolli që ai e ka arrestuar Sulejman Kokollarin,
14 Latife dhe Rushe Kolollin? Nuk është e kanë qenë aty vetëm për
15 të biseduar. Por i ka arrestuar. A e shikoni? A ju del kështu
16 të paktën nga paragrafi që lexuam, Dëshmitar?

17 PË. Këtu është fjala për Musë Qerkinin jo për -- a ishte për
18 Musë Qerkinin a Musë Kulollin? Për Musë Qerkinin. Ju thatë
19 Musë Kulollin.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo është ajo çka ka thënë
21 Musë Kulolli.

22 PË. Ah, Musë Kulolli. Okej.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E shihni që si Agim Zyba,
24 Naim Kulolli edhe Musë Kulolli kanë thënë të njëjtën gjë, që
25 kanë kuptuar njësoj që Latife dhe Rushe Kololli janë arrestuar

1 dhe janë ndaluar, të tre thonë të njëjtën gjë?

2 PË. Po ata e dinë qysh e komentojnë deklaratën e vet. Unë
3 s'muj me komentu deklaratën e atyne. S'kam të drejtë. [Folës
4 që flasin njëkohësisht] deshta --

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kalojmë në faqen
6 tjetër.

7 PË. -- me e shtu edhe një gjë. Sa për identifikim kanë qenë
8 edhe dy serbë që përmendëm më herët, ditën e djeshme. Edhe ata
9 kanë qenë në Budakovë që tash nuk po përmenden, ka qenë një
10 plak me një fëmijë të vogël 12-13 vjeçar. Edhe ai ka qenë i
11 legjitimuar s ka hi në zonë të luftës. Domethënë, kjo
12 legjitimimi ose identifikimi i personave ka vlejti për të
13 gjithë, për të gjithë që shkelin zonën e luftës, që shkelin
14 territorin ku ka vepruar batalioni jonë. Edhe ata janë sjellë
15 në Budakovë. Kemi bashkëbisedu. Bile ka bashkëbisedue një
16 person tjetër kur kam ardhë unë edhe që ka qenë --

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, ndaloni këtu,
18 Dëshmitar.

19 Po përsërisni veten, e dëgjuam një herë këtë.

20 Kalojmë tek faqja tjetër. Kjo faqe që keni përpara.

21 Pyetja që i bëhet Musë Kolollit ka të bëjë me shtëpinë.

22 Më konkretisht pyetja është kjo:

23 "Kush ishte pronari i shtëpisë ku u mbajtën personat e
24 zhdukur në gusht të 1998?"

25 Bëhet fjalë për Latife dhe Rushe Kolollin. Ai thotë:

1 "Pronari i shtëpisë ishte Palushi Bajram".

2 Pyetja tjetër është:

3 "A mund ta njohësh nga fotografia që po tregoj shtëpinë e
4 Palush Bajramit, Bajram Palushit?"

5 "Po e njoh shtëpinë e Bajram Palushit" thotë ai.

6 "A jeni në dijeni të faktit që ka pasur një zonë ndalimi
7 në zonën tuaj të përgjegjësisë dhe e kam fjalën konkretisht
8 për Batalionin e 2-të të Brigadës 123, a keni qenë në dijeni
9 ose a keni pasur informacion për një vend të tillë ndalimi,
10 Dëshmitar?"

11 PË. Jo. Unë nuk di që ka pas vend ndalimi. Që kjo shtëpia e
12 Bajram Palushit unë nuk e di cila është se nuk i njoh. Po bën
13 vaki Musa e njeh se ai ka qenë i q'atij fshati. Unë s'di për
14 cilën shtëpi e ka fjalën. Ai ka qenë i q'atij fshati,
15 sigurisht e din.

16 Po në përgjithësi ka qenë shtëpiat kanë qenë të
17 shkatërrume. S'po di për cilën shtëpi e ka fjalën. Bajram
18 Palushi. Unë as Barjam Palushin nuk e njoh.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju bëj një Ppetje
20 tjetër të shkurtër që ka të bëjë me deklaratën e fundit, për
21 procesverbal është dokumenti SPOE00201346. Është një deklaratë
22 e Sadri Emerllahut me të cilin ju na thatë që keni pas
23 marrëdhënie të mirë.

24 Ndërkohë që shfaqet në ekran, a mund të na thoni se çfarë
25 roli ka pasur ai në verë të vitit 1998, nëse ju kujtohet?

1 PË. A është pyetje për mu, ju lutem?

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, po pyetja ishte për
3 ju, në qoftë se e dini?

4 PY. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po së pari a mund të
6 konfirmoni që mund të na thoni se çfarë roli ka pasur ai në
7 verë të 1998?

8 PË. Sadri Emerllahu ka qenë shef i shtabit të Batalionit të
9 Parë në Budakovë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet në Batalionin e 1-
11 rë. Po mos e the gabim, bëhet fjalë për Batalionin e 2-të?

12 PË. Ndoshta dhe gabim. Unë e di batalioni i Budakovës i kemi
13 thënë të gjithë. Të parë e të dytë, batalioni i Budakovës.
14 Qështu e ka pas titullin. Është fjala për qatë, ndoshta dhe
15 mund të keqkuptohet.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta kalojmë
17 shkurtimisht. Përsëri atij i bëhet pyetje lidhur me Latife dhe
18 Rushe Kolollin. Pyetet në qoftë se ka qenë pjesë e policisë
19 ushtarake në atë kohë.

20 Le të kalojmë pak më poshtë në faqe dhe ai thotë:

21 "Po, policia ushtarake ka ekzistuar në atë kohë dhe pjesa
22 më e madhe e tyre ishin të veshur në uniforma të zeza, por ka
23 pasur dhe pjesëtarë të tjetër që njësisë që kanë pas uniforma
24 të ndryshme për shkak të çështjeve financiare".

25 Pyetja tjetër që i bëhet është kush ka qenë komandant i

1 policisë ushtarake ai përgjigjet duke thënë që në fillim ka
2 qenë Xhemajl Rexha ai, pastaj Musli Kololli e ka zëvendësuar
3 atë në gusht të 1998.

4 Të kalojmë tek faqja tjetër. Më pas pyetja që i bëhet
5 atij është kjo:

6 "A ka pasur ndonjë gjyqtar që ka punuar bashkë me
7 policinë ushtarake dhe që ka dhënë vendime sipas gjykatës?"

8 Përgjigja që ai jep është kjo:

9 "Po, në atë kohë ka qenë një jurist për këshillime
10 juridike brenda Batalionit të 2-të që quhej Nuredin Abazi dhe
11 ai ishte nga fshati Mushtisht".

12 Dhe përsëri këtu, si në rastin e z. Agim Zyba dhe Naimi
13 edhe z. Emerllahu e kishte kuptuar që ju punonit ngushtë me
14 policinë ushtarake. A është ky një kuptim i drejt i rolit që
15 keni luajtur ju atëherë, Dëshmitar, a është kuptuar siç duhet
16 ky roli juaj?

17 PË. Po e kam thënë. Edhe ashtu e kanë dit ata që jam jurist
18 pranë batalionit për qëllime juridike, e sa i përket
19 "gjykatës", gjykatës s'ka pas kërrkund. Askund nuk ka pas
20 gjykatës. Më duket se u përmend gjykatës, "ka qenë një
21 gjykatës". Unë s'kam qenë atëherë gjykatës. As kam punu
22 gjykatës përpara. Mbas luftës kam punu gjykatës. Para luftës
23 nuk kam punuar gjykatës kurrë.

24 Po jurist po. Jurist ka thënë jurist e na ka qenë një
25 gjykatës një jurist Nuredin Abazi. Shumë e vërtetë se unë jam

1 pej fshatit Mushtisht edhe ai është prej fshatit Mushtisht

2 Sadriu dhe njihemi edhe kështu.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në deklaratën që keni
4 dhënë në 2002, për procesverbal në dokumentin P11135, faqja 1,
5 ju keni thënë që:

6 "Për shkak se isha më i arsimuari ndërmjet ushtarëve të
7 tjerë, fillova të bashkëpunoja me policinë ushtarake. Gjatë
8 asaj kohe unë fillova që të ofroj shërbime si këshilltar i
9 policisë ushtarake sepse kisha njohuri për rregullat
10 juridike".

11 Pra, me kaq sa i keni thënë ju ZPS-së i takon që kjo
12 është një pajtim me atë çfarë ka thënë z. Emerllahu për juve
13 që ju keni bashkëpunu me policinë ushtarake. A do ishte
14 përskrim i drejt ky i rolit tuaj, Dëshmitar?

15 PË. Po, unë kam bashkëpunu me të gjithë, jo veç me policinë
16 ushtarake, me të gjithë, se detyrën e kam pas asi, me të
17 gjithë ushtrinë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja e fundit, z.

19 Emerllahu:

20 "Burgu a ka qenë në të njëjtën ndërtesë si shtabi?"

21 Përgjigja që ai jep është:

22 "Jo, burgu ishte në një shtëpi në periferi të Budakovës,
23 fshatit Budakovë, po nuk e di se kush ka qenë pronari i asaj
24 shtëpie".

25 Pyetja për juve është kjo:

1 Për çfarë burgju e ka fjalën z. Emerllahu që ishte jashtë
2 periferisë së Budakovës, apo edhe kësaj here nuk e keni fare
3 idenë se përpara çfarë vendi bëhet fjalë?

4 PË. Nuk e kam idenë. Mbasi po ditka ai na tregon. Unë s'kam
5 ide që ka pas burg, as ka pas kurrë. Po qysh e kanë marrë ata,
6 qysh e kanë perceptu unë bash nuk kam ide.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
9 Dëshmitar. Tani është pushimi i drekës. Do të rifillojmë në
10 orën 2.30, do të ktheheni serish në sallën e gjyqit sepse ka
11 pyetje të tjera. Tani mund të dilni nga salla me Asistenten.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
14 orën 2.30.

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.07

16 --- Seanca rifillon në orën 14.30

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace?

18 Z. PACE: [Përkthim] Ju faleminderit. Thjesht dëshiroj
19 t'ju them se e pamë komunikimin nga Trupi Gjykses lidhur me
20 parashtrimet me shkrim. Dua të them për procesverbal që
21 dokumenti ose është dorëzuar ose është duke u dorëzuar, lidhur
22 me atë çka diskutuam sot paradite. Këtë ua thashë vetëm për
23 t'ju vendosur në dijeni.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam një
25 urdhër me gojë, lidhur me kërkesën për redaktimin e pjesëve të

1 caktuara të shënimit përgatitor dhe diskutimet që bëmë ne
2 lidhur me dëshmitarin W03865.

3 Trupi Gjykses ka pasur për detyrë të rishikojë një
4 kërkesë të Mbrojtjes së Veselit për të redaktuar shënimin
5 përgatitor të dëshmitarit W0365 [Sipas përkthimit]. Është një
6 pjesë e dëshmisë së dëshmitarit, te e cila nuk do të
7 mbështetet ZPS-ja për vërtetësinë e përmbajtjes.

8 Kundërshtimet të natyrës së ngjashme të fokusuar në
9 detyrimet e palëve për të -- nuk duhet -- nuk duhet t'ju --
10 nuk duhet t'ju jepen Trupit Gjykses nëse besohet se janë të
11 rreme dhe ky është një kundërshtim që e ka bërë Mbrojtja e
12 Thaçit.

13 Shënimi Përgatitor u pranua tashmë si provë materiale
14 P01137.

15 Trupi Gjykses jep këtë vendim lidhur me këtë
16 parashtrimin.

17 Sikurse pritej nga ZPS-ja, ZPS-ja i ka dhënë njoftim të
18 saktë dhe të plotë Mbrojtjes si dhe Trupit Gjykses lidhur me
19 dëshminë që ka dhënë dëshmitari W03865 gjatë seancës
20 përgatitore. Të gjitha palët janë pajtuar se kjo dëshmi
21 përmbante pretendime e akuza që janë në mospërputhje me
22 dëshmitë e mëparshme që ka dhënë UNMIK-ut dhe ZPS-së.

23 Trupi Gjykses është i bindur se në shënimin përgatitor i
24 ka dhënë njoftim të mjaftueshëm Mbrojtjes lidhur me ndryshimet
25 që ka pasur dëshmitari në dëshmitë e veta përkatëse.

1 Trupi Gjykues më tej është i bindur se përfshirja e
2 angazhimit të përfaqësuesit të ZPS-së lidhur me -- më falni,
3 shprehja e mospërputhjeve të dëshmitarit nga ZPS-ja është
4 krejt normale edhe ZPS-ja nuk ka kundërshtuar dëshminë e re
5 për vërtetësinë e përmbajtjen.

6 Trupi Gjykues më tej vëren se përfaqësuesit e ZPS-së
7 qartazi i kanë theksuar këto kontradikta të dëshmitarit gjatë
8 dëshmive që ka dhënë me gojë.

9 Rrjedhimisht, është e qartë që nuk do të mbështetet
10 sidoqoftë në dëshminë e re për vërtetësinë e përmbajtjes dhe
11 Trupi Gjykues është i bindur se nuk është shkaktuar asnjë dëm
12 Mbrojtjes nga kjo procedurë që është ndjekur.

13 Sidoqoftë, nëse ndodhin situata të tilla të ngjashme,
14 ZPS-ja duhet të jetë shumë e kujdesshme në mënyrë që të
15 nxjerrë të gjitha informacionet kontradiktore *viva voce* me
16 dëshmitarët dhe nuk duhet që kërkojë që dëshmitarët të
17 trajtohen sipas Rregullës 154.

18 Bazuar në ato që cekta më herët, nuk është nevoja që të
19 justifikohet kërkesa për të redaktuar pjesët përkatëse të
20 shënimit përgatitor. Çdo mospërputhje që ekziston mes dëshmisë
21 në shënimin përgatitor dhe dëshmive të mëparshme të
22 dëshmitarit, do të shqyrtohen vetë nga Trupi Gjykues kur të
23 vlerësojë besueshmërinë e këtij dëshmitari dhe
24 mbështetshmërinë e provave të këtij dëshmitari lidhur me këtë
25 aspekt. Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
3 të vazhdojmë me pyetjet e gjykatësve.

4 Gjykatësi Mettraux ka ende fjalën.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar. Do
